Në marrëdhëniet e jashtme me Aleatët britanikë, që vetëm ishin të parët që çelën “sezonin” e këtyre marrëdhënieve, por edhe në gjithë teatrin shqiptar të luftës, kishte disa veçori. Mbi to shfaqeshin dritëhije, ashtu si dhe mjaft kundërshti, mosbesim e dyshime, të cilat pengonin zhvillimin normal të vetë marrëdhënieve. Këto dukuri e kishin burimin dhe lidheshin me disa aspekte të natyrës kryesisht politike, por edhe ushtarake e logjistike. Madje, të para në kontekstin kohor, por edhe të Luftës së Dytë Botërore, mund të shpjegohen lehtë disa prej arsyeve me motive politike. Nëse u referohemi të dhënave dokumentare, realizimit të marrëdhënieve midis misioneve ushtarake aleate dhe forcave të Qëndresës shqiptare, vërehet lehtë se nuk kanë qenë aspak të lehta. Kjo dukuri u shfaq që me vendosjen e kontakteve midis Misionit të Parë ushtarak aleat britanik të sapoardhur në territorin e Shqipërisë dhe përfaqësuesve të Lëvizjes NÇ shqiptare. Del se vendosja e kontaktit, takimit dhe vendosja e marrëdhënieve ishte vërtetë e vështirë, e paparashikueshme për pjestarët e këtij misioni i cili, tek e fundit, ishte dërgatë e një prej Aleatëve të mëdhenj të Koalicionit Antifashist Botëror, i Britanisë së Madhe, të cilët në fillim ndeshën në një qëndrim dyshues, indiferent i përfaqësuesit të LNÇ, që në takimin e parë me ta.

**MARRËDHËNIET NDËRKOMBËTARE ME MISIONET BRITANIKE GJATË
LUFTËS SË DYTË BOTËRORE**

Misionit i Parë ushtarak aleat britanik i ardhur në territorin e vendit tone priste një takim më të ngrohtë, afrues dhe mbështetës, pasi ata ishin misionarë të ardhur nga një vend aleat për të ndihmuar forcat shqiptare në luftën kundër pushtuesve fashistë dhe nazistë! Ja si e përshkruan një prej pjestarëve të misionit, madje nënkomandanti i tij, kapiteni David Smajlli, takimin me përfaqësuesin e parë të LNÇ të Qarkut të Gjirokastrës: *“Nivani ishte një fshat i thjeshtë shqiptar. Na u tha se Bedri Spahiu ishte komandant gueril i zonës dhe do të vinte të nesërmen të na takonte. Bedri Spahiu kishte një karakter të thartë...Takimi ynë nuk pati suksesin që prisnim. Me naivitet kishim menduar se ai do të mirëpriste njerëz nga një vend në luftë me armiqtë e tij, që ishin të gatshëm të ndihmonin në luftën kundër okupatorëve italianë. Përkundrazi, na la përshtypjen se dyshonte për qëllimet tona dhe pothuajse shfaqti një qëndrim armiqësor. Na tha se nuk duhej të*

futeshim më thellë në tokën shqiptare dhe do të ishte më mirë sikur të ktheheshim në Greqi menjëherë”¹.

Zhgënjimi dhe çudia e Smajllit vijon më tej teksa ai shkruan për prezantimin me përfaqësuesin e mësipërm të LNÇ: *“Po pika më me rëndësi që doli nga kjo bisedë ishte kur na informoi se ai ishte i Lëvizjes Nacional-Çlirimtare, shkurt LNÇ. Ky ishte takimi i parë më këtë organizatë për të cilën nuk dinim asgjë të saktë. Ai na tha se Komanda e tyre e Përgjithshme ishte afër Tiranës. Pas një insistimi, arriti të bindej dhe pranoi të dërgonte një letër tonën drejtuar asaj komande, por do të duheshin të paktën dhjetë ditë për të pasur, një përgjigje, dhe ndërkohë duhej të largoheshim, duke u kthyer në Greqi dhe të prisnim aty”².* Kapiteni Smajlli e përmbyll këtë përshkrim me fjalët: *“Iniciativa për të ndihmuar shqiptarët nuk kishte pasur sukses dhe duhej pritur përgjigja nga Komanda e Përgjithshme në Tiranë”³.*

Ndoshta ky qëndrim nihilist dhe paragjykues i shqiptarëve ndaj britanikëve duhet parë edhe një këndvështrim paksa historik, të paktën që nga Kongresi i Berlinit dhe Konferenca e Londrës e 29 Korrikut 1913 dhe vendimet e tyre për ndarjen e kufijve të Shqipërisë. Që prej asaj kohe, kur nga trangu shqiptar u shkëputën shumë territore, që i kaluan padrejtësisht vendeve fqinjë, si Mali i Zi, Serbia dhe Greqia, shqiptarët i shihnin me paragjykim dhe mosbesim Fuqitë e Mëdha dhe sidomos Anglinë!

Më pas, më 17 dhjetorin e vitit 1942, kur tre Aleatët e Mëdhënj bënë të njohura Deklaratat njohëse të Rezistencës Antifashiste të popullit shqiptar, përsëri, në Deklaratën e Ministrit të Jashtëm të Anglisë u vu në diskutim çështja e kufijve të Shqipërisë, pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore! Deklarata, e cila erdhi e treta, pas asaj të qeverisë së SHBA dhe Bashkimit Sovjetik e cila përfundonte me paragrafin, që do të ngjallte një reaksion të fortë tek shqiptarët. Në të shkruhej: *“Qeveria e Madhërisë së Tij e shikon çështjen e kufijve të shtetit shqiptar pas lufte, si një çështje që do të duhet të merret me shqyrtimin në Konferencën e Paqes”⁴.* Kjo deklaratë ndryshonte nga ato të SHBA dhe Bashkimit Sovjetik, të bëra të njohur para asaj të Forin Ofisit Britanik. Deklarata britanike ndryshonte në dy çështje të rëndësishme me atë të dy Aleatëve të

¹ David Smajli. Vitet Shqiptare ‘40-’44, (Tiranë: UET-Press, 2012), 33-34.

² Po aty, 34.

³ Po aty.

⁴ TNA, FO.371/33107, viti 1942, fq.57. (Cituar sipas librit Kaba, Hamit, Shqipëria dhe të Mëdhenjtë nga Lufta e Dytë Botërore në Luftën e Ftohtë. (Tiranë: KLEAN, 2015), 21).

tjerë. Kështu, Deklarata e SHBA vlerësonte qëndresën antifashiste të shqiptarëve kundër fashistëve, por edhe “i referohej Kartës së Atlantikut për formën e qeverisjes dhe qeverinë që do të zgjidhnin shqiptarët pas luftës”.⁵ Ndërkohë, edhe qeveria e Bashkimit Sovjetik vlerësonte dhe bënte të njohur përkrahjen “për luftën e guximshme çlirimtare të patriotëve shqiptarë dhe dëshirën për ta parë Shqipërinë të çliruar nga zgjedha e pushtuesve fashistë dhe Pavarësinë e saj të rivendosur”.⁶ Pikërisht parashtrim i fundit, i Deklaratës Britanike i cili ndryshonte nga dy deklaratat e mëparshme të SHBA dhe Bashkimi Sovjetik e irritoi dhe ngriti një valë të fortë reagimi në opinionin e ndjeshëm mbarë shqiptar të kohës, brenda dhe jashtë Shqipërisë. Kjo frymë do të përshkonte kohën dhe raportin mes asaj që ofronte deklarata britanike në tërësi me njohjen e saj dhe asaj që paralajmëronte paragrafi përmbyllës i kësaj deklarate. Ndoshta, ky qëndrim, ishte një ndër pikat më të ndjeshme të kujtesës dhe ndërgjegjes historike kombëtare, që lidheshin dhe ngacmonin një plagë të vjetër të shqiptarëve, atë të cungimit të kufijve dhe territoreve të atdheut të tyre, në interes të shteteve shoviniste fqinje.

Kjo ndjesi nuk do të reflektonte vetëm tek udhëheqja e LNÇ shqiptare, tek e cila ajo ndërlidhej edhe me aspektin ideologjik që përshkonte këtë lëvizje të udhëhequr nga PKSH. Ajo do të përshfaqej edhe tek lëvizja zogiste e Abaz Kupit, për të cilin, më se një vit më pas, do të publikohej në një gazetë shqiptare të kohës, se: “Abaz Kupi për rrjedhim të kësaj kërkoi prej Anglisë që kjo të garantojë solemnisht kufijtë e Shqipërisë. Mirpo as Abas Kupi, as edhe ndonji Shqiptar tjetër nuk ka marrë deri më sot ndonji përgjigje ose garanci prej Anglisë. Përse po i shmangen Anglija dhe Shtetet e Bashkueme garantimit të kufijëve të Shqipërisë”.⁷ Nihilizmi dhe mosbesimi janë shumë të dukshme e të qarta në të.

Por, padyshim tipike për këtë shfaqje mosbesimi dhe dyshimi ndaj britanikëve ishte Lëvizja NÇ, veçanërisht e udhëheqjes së saj. Pse? Kjo ishte lehtësisht e shpjegueshme nëse mbajmë parasysh që kjo lëvizje, më së shumti udhëheqja e saj, mendonte dhe pretendonte se ishte pikërisht ajo që mbante peshën e luftës kundër pushtuesve nazistë gjermanë në Shqipëri. Përkundrazi, forcat e tjera ose ishin indiferente dhe të tërhequra në pritje ose, kishin zgjedhur të bashkëpunonin me pushtuesit! Dhe, ky qëndrim i LNÇ nuk ishte pa arsye dhe motiv. LNÇ i gjente shpjegimet në shfaqjen dhe daljen në skenën politike dhe atë të luftës antifashiste përpara forcave të tjera politiko-

⁵ Deklaratë e Sekretarit të SHBA, Nr.543, Sekret, fq.148. Tek FO, 371/33108.

⁶ Arben Puto, Një analet e diplomacisë Angleze. (Tiranë: Albin, 2001), 56-57.

⁷ AQFA, F.100/1, viti 1944, D.102, Gazeta “Shqipëria”, më 7 Prill 1944.

ushtake shqiptare, që me krijimin e PKSH dhe fillimet e kryengritjes së armatosur kundër fashistëve, në dhjetor të vitit 1941. Forcat e tjera, si Balli Kombëtar dhe Legaliteti dolën në skenën politike-luftarake shqiptare, disa muaj më pas dhe njëri pas tjetrit.⁸

Një argument tjetër përbënte fakti që forcat e LNÇ e kishin filluar luftën e organizuar, natyrisht me formacione të vogla taktike, kundër pushtuesve disa muaj para njohjes nga Aleatët e Koalicionit të Madh Antifashist Botëror, me deklaratat e tyre të dhjetorit 1942. Madje, LNÇ i kishte shtuar në numër forcat e veta luftarake dhe pjesëmarrjen në luftën kundër pushtuesve në fushën e luftës, ndërkohë që Balli Kombëtar qëndronte larg kësaj lufte madje bashkëpunonte me pushtuesit e rinj gjermanë, kurse Legaliteti kishte zgjedhur të rrinte në pritje!

Ndërkohë, fryma e mungesës së mirëkuptimit dhe bashkëpunimit mbizotëronte dhe ndante, si një “shtresë e trashë dhe e ftohë akulli”, forcat shqiptare brenda Qëndresës shqiptare. Kjo gjendje pengonte edhe vetë marrëdhëniet midis këtyre forcave dhe Aleatëve! Kjo sepse ishte në politikën e Aleatëve që në luftën kundër pushtuesve të përfshiheshin sa më shumë forca vendase që e luftonin atë. Kjo klimë në marrëdhëniet me misionarët ushtarakë aleatë britanikë pasqyrohej qartë, sidomos në takimet e drejtuesve të forcave shqiptare të Qëndresës me ta. Ka mjaft të dhëna të kohës që hedhin dritë mbi takimet e forcave shqiptare me misionarët britanikë, por më të dukshme janë ato mes tyre dhe udhëheqjes së LNÇ. Fryma e dyshimit dhe e mosbesimit ndihet lehtësisht në takimet, bisedimet dhe debatet e vijueshme mes tyre. Por jo rrallë fryma e mosbesimit frynte edhe takimet dhe negociatat e aleatëve britanikë me përfaqësuesit apo drejtuesit e forcave nacionaliste shqiptare, të Ballit Kombëtar apo Legalitetit.

Në takimet e udhëheqjes së LNÇ, pothuajse të kryesura nga Enver Hoxha, si me majorin Bill Maklin ashtu edhe me gjeneralin Dejvis shfaqeshin, gati-gati përherë, tonet dhe ngarkesat e larta mosbesuese. Pasi majori Bill Maklin e njoftoi Enver Hoxhën për ardhjen e gjeneralit Dejvis dhe i paraqiti kërkesën e tij për t’u pritur dhe dëgjuar atë, udhëheqësi i PKSH dhe i LNÇ, do të shkruante lidhur me reagimin ndaj kësaj kërkesë: *“Isha më se i bindur që më parë se ardhja e këtij misioni anglez në Shqipëri më një general në krye nuk do t’i sillte ndonjë përfitim të dukshëm Luftës sonë Nacionalçlirimtare. Gjenerali me siguri do të ndiqte ndaj nesh po atë strategji dhe taktikë që ndoqën paraardhësit e tij....”*⁹ Më poshtë, Enver Hoxha do të shtjellonte me detaje atë që

⁸ Më parë, në dhjetor të vitit 1942 u krijua organizata politike e Ballit Kombëtar, kurse më 23 nëntor 1943, në Zall-Herr pranë Tiranës u formua Legaliteti me simpatizantë zogistë.

⁹ Enver Hoxha, *Rreziku anglo-amerikan për Shqipërinë (Kujtime)*. (Tiranë: 8 Nëntori, 1982), 72.

mendonte ai lidhur me strategjinë dhe taktikën” e anglezëve në Shqipëri. Ai ka shkruar lidhur me takimin e gjeneralit Dejvis se: “....domethëne do të ndihmonte me pak armë, me pak municione e veshëmbathje sa për të justifikuar ardhjen dhe qëndrimin pranë nesh, do të jepte edhe disa qindra stërlina flori për të thënë: ‘Përpikuni të blini armë, kontrabandë nga ushtarët pushtues’ etj”.¹⁰ Sipas këndvështrimit të Enver Hoxhës, detyra e misioneve ushtarake angleze, ishte që në bazë të informatave të mbledhura, “...të ndërtonin strategjinë dhe taktikën e tyre për ndërhyrje në Shqipëri”.¹¹

Por, gjithnjë sipas Hoxhës, qëllimi i anglezëve ishte edhe më i thellë dhe më i largët. Ai shkruan: “Në ç’konkluzione kisha arritur unë për sa i përket veprimeve të anglezëve? Ata, pavarësisht se luftonin kundër Italisë fashiste dhe Gjermanisë hitleriane, pavarësisht se ishin aleatë me ne që luftonin kundër armiqëve të njëjtë, synonin të dobësonin Luftën tonë Nacionalçlirimtare...”¹². Kështu i portretizonte dhe përcaktonte misionarët aleatë anglezë, udhëheqësi i PKSH, mbështjellë me dyshim dhe mosbesim!

Një shkak tjetër që e nxiste më tej dyshimin dhe mosbesimin e Enver Hoxhës ishte edhe vendosja e misioneve ushtarake pranë forcave nacionaliste të Ballit Kombëtar dhe Legalitetit. Duket se ishin edhe këto arsye dhe rrethana që e kishin shtyrë atë që të urdhëronte kufizimin e afrimit dhe njohjes së misionarëve ushtarakë britanikë, në pikëpamje të planeve dhe çështjeve ushtarake, si dhe strategjisë, taktikës ushtarake dhe organizimit të formacioneve luftarake të LNÇ etj. Për këtë dukuri Hoxha, pas ardhjes së Misionit të Parë ushtarak britanik pranë qendrës së drejtimit, më pas pranë Shtabit të Përgjithshëm të UNÇSH, pas krijimit të tij më 10 korrik të vitit 1943, ka shkruar se misionarët aleatë donin të, “...informoheshin mbi çdo gjë, të njohnin forcën tonë, taktikat dhe strategjinë tonë. Ata i pretendonin këto në mënyrë miqësore”, si “aleatët” tanë të mëdhenj në luftën kundër të njëjtit armik, nazifashizmit, trumbetonin se kishin ardhur të na ndihmonin me armë, me veshëmbathje dhe, me pamundësi me ushqime,...Nga ana tjetër, ata premtuan se do të propagandonin Luftën tonë Nacionalçlirimtare”.¹³

Por, ajo që do ta finalizonte këtë qëndrim vinte më pas, atëherë kur, në muajt korrik-gusht në Shqipëri po vinin njëri pas tjetrit misione të tjerë ushtarake britanike dhe udhëheqja e LNÇ

¹⁰ Po aty.

¹¹ Po aty, 73.

¹² Hoxha, Rreziku anglo..., Vep.përm, 73.

¹³ Po aty, 42.

hodhi parrullën: “Kudo të mbahet i njëjti qëllim: Korrektësi dhe vigjilencë! Anglezët në asnjë rast nuk duhen lejuar të futin hundët në punët tona të brendshme. Konspiracion të madh për të gjitha çështjet e Partisë: Të gjithë për ta ne jemi partizanë...”¹⁴

Ky qëndrim ju diktua reparteve partizane të LNÇ, në të cilat ishte e detyrueshme mospërzierja e misionarëve aleatë në punët e brendshme të formacioneve luftarake. I tillë ishte rasti i batalionit partizan të Pezës, që komandohej nga nacionalisti Myslym Peza. Ardhjen e një misioni ushtrak britanik pranë batalionit të tij, Myslym Peza e priti, por me kushtin që, “...të vijë një mision, por jo më tepër se tre veta dhe me kusht mos me u përzi me punët tona të mrenshme; të ketë lidhje vetëm me mu dhe me komisarin; mos me u taku me reaksionarët, me armiqtë tanë, dhe të na hudhin armë”.¹⁵

Duket se një ndër motivet më të forta për debatet mes LNÇ dhe misioneve ushtarake aleate britanike kanë qenë këmbëngulja dhe nismat e aleatëve për të krijuar lidhje dhe marrëdhënie, madje duke u vendosur me mision të veçanta edhe pranë forcave të Ballit Kombëtar e Legalitetit.

Përplasjet më të ashpra e të vijueshme për të normalizuar marrëdhëniet midis palëve shqiptare, ndodhnin gjatë diskutimeve të shpeshta lidhur me trajtimin e forcave nacionaliste të Ballit Kombëtar dhe të Legalitetit me të njëjtat “standarte” si dhe me LNÇ. Kjo shfaqej edhe pse ishte i njohur për të gjithë qëndrimi pritës dhe indiferent i legalistëve të Abaz Kupit dhe ai bashkëpunues i forcave të Ballit Kombëtar me nazistët gjermanë.

Natyrisht që qëndrimi i misioneve ushtarake aleate britanike ndaj forcave nacionaliste të Ballit Kombëtar dhe të Legalitetit, duke u vendosur pranë tyre, ashtu si dhe tek forcat e LNÇ, ishte në qëllimin e vetë misioneve. Kjo bëhej me synimin që t’i mbështesnim dhe ndihmonim forcat shqiptare të mësipërme, në organizimin, asistencën ushtarake e llogjistike dhe, sidomos, që të punonin për t’i bindur këto forca dhe t’i tërhiqnin ato në luftën e përhershme dhe efektive kundër pushtuesve, gjë që ishte dhe strategjia e Aleatëve të Mëdhenj. Për t’ia arritur kësaj sigurisht që kërkohej së pari pajtimi, bashkimi dhe rreshtimi i gjithë faktorëve të Qëndresës shqiptare “në një front të përbashkët lufte”¹⁶.

Por, gjithësesi, koha dhe zhvillimi i ngjarjeve vërtetuan se rezultatet e marrëdhënieve mes Aleatëve dhe forcave shqiptare, pikërisht në këtë tregues me përparësi, nuk pati pritshmëritë e

¹⁴ Po aty, 43.

¹⁵ Po aty.

¹⁶ Historia e Popullit Shqiptar, Vëll.IV. (Tiranë: TOENA, 2008), 111.

duhura. Prandaj edhe përpjekjet shkuan dëm sepse që e pamundur të gjendej gjuha e pajtimit dhe, për rrjedhojë edhe bashkëpunimi për luftën kundër pushtuesve. Siç shkruhet në Historinë e Popullit Shqiptar, forcat nacionaliste, “që vepruan jashtë Frontit Nacionalçlirimtar nuk gjetën as rrugën e luftës së armatosur kundër pushtuesit, sidomos pas vjeshtës së vitit 1943”.¹⁷

Forin Ofisi britanik nuk e bëri të hapur e të njohur qëndrimin kritik ndaj Ballit Kombëtar për raportin që kjo forcë mbante me luftën e armatosur kundër pushtuesve gjermanë si dhe me këta të fundit. Madje, zyrtarët britanikë bënë çmos për ti dhënë një imazh këtyre forcave, atë të një force të Qëndresës shqiptare, e cila ishte aktive në luftën kundër pushtuesve gjermanë! Kjo sjellje e aleatëve britanikë solli për rrjedhojë një kundërshtim të ashpër dhe të menjëhershëm të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë NÇ Shqiptare. Por, zinxhiri i reagimeve lidhur me qëndrime ndaj Ballit Kombëtar nga Londra zyrtare, ishte po aq të ndjeshme dhe kritike. Veçanërisht refraktare ishin raportet e gjeneralit Dejvis, Bill Tillman dhe Norman Uiller etj.,. Pikërisht mungesa e denoncimit dhe kritikës ndaj Ballit Kombëtar për bashkëpunim me pushtuesit, ashtu si dhe Qeverinë Kuislinge të Tiranës; mospublikimi dhe bërja e njohur e luftës së pandërprerë, si dhe e përpjekjeve të luftëtarëve të Lëvizjes Antifashiste Nacionalçlirimtare, ishte ajo që përbënte thelbin e “*dyshimit dhe zemërimit me qeverinë britanike*”.¹⁸ Por, edhe forca tjetër shqiptare, ajo e Legalitetit, pas kapitullimit të Italisë fashiste dhe ardhjes së pushtuesve gjermanë, kishte ndenjur e tërhequr nga lufta dhe në pritje, pa u përfshirë në veprime luftarake kundër pushtuesve. Kjo kishte ndodhur edhe pse kishte marrë premtime dhe disa furnizime me armatime etj., nga aleatët britanikë, qëndrime e furnizime këto, që kishte zgjuar reagimin e LNÇ si dhe të disa misionarëve ushtarakë anglezë në Shqipëri.

Megjithatë, zyrtarët anglezë edhe me propozimin e disa misionarëve ushtarakë britanikë, si Maklini, Smajlli dhe Emeri, me miratim të Forin Ofisit, menduan që të bazoheshin tek Legaliteti për t’a përdorur “*si mbështetje kryesore e strategjisë angleze në Shqipëri*”.¹⁹ Por, që të arrihej ky qëllim duhej që Legaliteti të dilte nga pozicioni pritës ndaj armikut pushtues. Kjo lëvizje ishte dhe kushti i vënë për këtë forcë nga ana e Shtabit Aleat të Mesdheut. Por, Legaliteti nuk i plotësoi këto pritshmëri të anglezëve, gjë që e shfrytëzoi udhëheqja e LNÇ, së pari për të fajsuar misionet aleate për tolerancën ndaj Abaz Kupit dhe forcave të tij legaliste dhe, së dyti, për t’a braktisur idenë e

¹⁷ Po aty.

¹⁸ Po aty.

¹⁹ Po aty, 111-112.

mbështetjes së kësaj force që nuk merrte pjesë në luftën kundër pushtuesve nazistë. Nga ana tjetër, udhëheqja e LNC e vlerësonte këtë qëndrim të anglezëve si një sfidë dhe kundërvënie që i bëhej Lëvizjes Antifashiste NÇ.²⁰

Por, mosmarrëveshjet lidhur me këtë do të merrnin përmasa dhe zhvillime të reja, të ashpra pas 28 majit 1944.²¹ Njëherëshi këta faktorë kishin bërë që marrëdhëniet ndërkombëtare, sidomos në aspektin politik, por edhe ushtarak e llogjistik, të mos ngjiteshin dot në nivelin e duhur, aq sa të ndikonin e të ndihmonin sa duhej në zgjidhjen e tyre. Më e dukshme ishte kjo pamjaftueshmëri në aspektin politik, ku nuk iu arrit që të gjindej një zgjidhje për të tërhequr në luftë të gjitha forcat që përbënin Qëndresën shqiptare.

Po ashtu, marrëdhëniet midis Aleatëve dhe forcave shqiptare, të periudhës maj 1943-1944, u karakterizuan nga përpjekjet për të zgjidhur problemet e rëndësishme të llogjistikës ashtu si dhe ato ushtarake. Këto ishin dy prej problemeve për t'a bërë luftën e forcave shqiptare sa më efektive dhe mëposhtjen e armikut të përbashkët, fashizmit dhe nazizmit.

Duke u mbështetur në dokumentacion arkivor dhe botimet shkencore, të cilat u janë kushtuar misionëve ushtarake aleate që erdhën dhe vepruan në Shqipëri, pranë forcave të Qëndresës Shqiptare Antifashiste mund të nxirren disa përfundime që lidhen me marrëdhëniet ndërkombëtare mes tyre.

Së pari, deri në fundin e Muajit maj 1944, marrëdhëniet midis aleatëve dhe faktorëve kryesorë të Qëndresës Antifashiste Shqiptare ishin vendosur edhe filluan të realizoheshin nëpërmjet misionëve ushtarake aleate angleze dhe amerikane. Kështu, mund të thuhet se këto marrëdhënie ishin vendosur mbi bazën e disa “institucioneve” të veçantë të “Kuartiereve (Shtabeve) të Malit” shqiptare dhe atyre të aleatëve të Mëdhenj, organizmave, komandave apo agjensive të posaçme të tyre, të vendosura në Mesdhe, fillimisht në Kajro dhe më pas më pranë, në Bari të Italisë.

Pavarësisht se misionet aleate kishin përbëheshin kryesisht nga ushtarakë të vendeve aleate përkatëse, ata kishin disa objektiva që mund t'i kapërcenin ato me karakter ushtarak pra edhe të aspektit politik-ideologjik. Ato do ishin i marrëdhënie midis misionëve dhe faktorëve politiko-ushtarakë shqiptarë përbërës të Qëndresës.

²⁰ *Historia e Popullit Shqiptar*, Vëll.IV. (Tiranë: TOENA, 2008),112.

Pikërisht përmes marrëdhënieve, të vendosura pranë institucioneve të mësipërme, ishte arritur tashmë të bëhej qartazi dallimi midis këtyre faktorëve, se cili prej tyre ishte përfshirë tërësisht në luftën kundër fashizmit dhe nazistëve, dhe kjo ishte LNÇ e udhëhequr nga PKSH. Njëherëshi ishte identifikuar se Balli Kombëtar, megjithë përpjekjet e aleatëve përmes misioneve aleate pranë tyre për t'i tërhequr në këtë luftë, nuk donin të përfshiheshin në këtë luftë, madje ishte faktuar dhe dokumentuar se ata bashkëpunonin me nazistët dhe Qeverinë Kuislinge të Tiranës kundër forcave të LNÇ. Ndërkohë faktori tjetër shqiptar Legaliteti, ishte indiferent dhe i tërhequr. Ai e kushtëzonte pjesëmarrjen në luftën antinaziste me kushtin e furnizimit paraprakisht me armë, municione dhe logjistikë nga aleatët, pastaj të hynin në luftë!

Afro një vit më pas (maj 1943-1944) marrëdhëniet midis Aleatëve të Mëdhenj (Angli dhe SHBA) dhe faktorëve kryesorë të Qëndresës antifashiste shqiptare, ishin vendosur dhe ishin vënë në rrugën e ecurisë dhe realizimit të tyre, deri diku, ndonëse jorrallë me debate mes përfaqësuesve të faktorëve të Rezistencës Shqiptare për tri çështje apo aspekte kryesore: politiko-ideologjike, ushtarake dhe llogjistike.

Në sajë të këtyre marrëdhënieve, Rezistenca Shqiptare, e vendosur, e mbështetur dhe e ndikuar nga misionet ushtarake aleate, me ndihmesën politike, asistencës në pikëpamje ushtarake dhe e mbështetur në pikëpamje llogjistike, ishte rritur në përmasa numerike, në sferën e organizimit dhe në aspektin ushtarak.

Për të vërtetuar faktin që misionarët aleatë ishin njëherëshi edhe emisarë të marrëdhënieve ndërkombëtare mes aleatëve dhe forcave politike e luftarake shqiptare, do të ishin të mjaftueshëm pozicionimet e majorit Bill Maklin dhe gjeneralit Dejvis. Më parë Maklini dhe më pas Dejvisi, në rolin e këtyre emisarëve “diplomatikë” shkuan, takuan dhe biseduan më se njëherë me përfaqësuesit e lartë të faktorëve politiko-luftarake të LNÇ, Ballit Kombëtar dhe Legalitetit për çështjet politike, ushtarake dhe llogjistike, për bashkëpunimin e këtyre forcave, gjëra për të cilat ata vunë në dijeni me radiograme, dhe, sidomos përmes raportimeve zyrtare por edhe me takime të drejtëpërdrejta, drejtimet e tyre. Paskësaj ata vepruan në përputhje me udhëzimet e institucioneve të tyre përkatëse. Dhe e gjithë kjo ngjante, ashtu siç shkruante lidhur me këto marrëdhënie, gjenerali Dejvis, *“Megjithëse këto mundësi ishin të mëdha, ndërlidheshin në*

drejtimin e luftës nga Londra, që duhej të peshonte mundësitë kundër shpërdorimit të burimeve që do të caktoheshin".²¹

Gjithësesi periudha pasuese e luftës në Shqipëri, e cila nga maji i vitit 1944 do të fitonte përmasa të reja dhe zhvillime të ndjeshme në pikëpamje ushtarake, do të eidentonte edhe më qartë rolin dhe ndikimin e misioneve aleate edhe në forcimin e marrëdhënieve ndërkombëtare mes tyre dhe Rezistencës Shqiptare.

Por, natyrisht, përmes këtyre informacioneve, radiogrameve dhe raporteve të misioneve aleate britanike janë bërë vlerësime lidhur me forcat e Qëndresës shqiptare, të njohura prej Aleatëve të Mëdhenj të Koalicionit Antifashist Botëror. Për rrjedhojë, nëpërmjet këtyre raporteve është bërë evidente dhe e dukshme, veprimtaria e Qëndresës shqiptare, me forcat e saj përbërëse, në raport me atë që ishte thelbësore, me qëndrimin dhe pozicionimin ndaj luftës kundër pushtuesve fashistë dhe nazistë.

KONKLuzion

Sipas raporteve të misioneve aleate ushtarake britanike që mbërritën të parët në territorin e Shqipërisë, nga Misioni i Parë, ai i gjeneralit Dejvis dhe ato të Verës 1943, forcat kryesore që ishin pozicionuar qartë dhe në vijueshmëri ndaj forrave pushtuese fashiste dhe naziste, ishin ato të LNÇ. Ndërkohë forcat e Ballit Kombëtar, që me Operacionin nazist të Dimrit 1943-1944, të ndërmarrë kundër forcave të LNÇ, ishin vënë hapur në bashkëpunim me ushtrinë naziste gjermane në Shqipëri. Kurse forcat e Legalitetit qëndronin në pritje, të tërhequra nga kjo luftë, të paktën që prej vjeshtës së vitit 1943.

Për këtë arsye, pothuajse të gjitha raportet e misioneve ushtarake aleate britanike në Shqipëri, propozojë përkrahja dhe mbështetja e forcave të LNÇ. Njëherëshi i propozojë qeverisë britanike denoncimi i Ballit Kombëtar për bashkëpunimin e pushtuesit dhe qeverinë Kuislinge të Tiranës kundër LNÇ, kurse nacionalistët e Legalitetit, për qëndrimin pasiv dhe kushtëzues për pjesëmarrje në këtë luftë!

Tek e fundit, në propozimet e misionarëve aleatë, bazojë edhe niveli i marrëdhënieve ndërkombëtare me forcat e Qëndresës shqiptare deri në maj të vitit 1944, kohë kjo që përcaktonte edhe kufirin me fazën përfundimtare të Luftës Antifashiste NÇ në Shqipëri.

²¹ Dejvis, *Aventura Ilire*, (Tiranë: Qendra e Studimeve Ndërdisciplinore, pa vit botimi).

Në përmbyllje mund të thuhet se, ardhja dhe veprimtaria e misionëve ushtarakë aleatë në Shqipëri, si dhe vendosja e marrëdhënieve ndërkombëtare mes tyre me forcat shqiptare të Qëndresës, ishte e diferencuar me to, në varësi të faktorëve luftarakë, por edhe të atyre politikë dhe ideologjikë.

Referenca:

1. Smajli, David. Vitet Shqiptare '40- '44. Tiranë: UET-Press, 2012;
2. Kaba, Hamit, Shqipëria dhe të Mëdhenjtë nga Lufta e Dytë Botërore në Luftën e Ftohtë. Tiranë: KLEAN, 2015;
3. AQFA, F.100/1, viti 1944, D.102;
4. Gazeta "Shqipëria", më 7 Prill 1944;
5. Puto, Arben. Nëpër analet e diplomacisë Angleze. Tiranë: Albin, 2001;
6. Hoxha, Enver. Rreziku anglo-amerikan për Shqipërinë (Kujtime). Tiranë: 8 Nëntori, 1982;
7. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Historia e Popullit Shqiptar, Vëll.IV. Tiranë: TOENA, 2008;
8. Gjenerali Davies, Aventura Ilire. Tiranë: Qendra e Studimeve Ndërdisciplinore, pa vit botimi.

Biljana CIGLOVSKA, PhD

International University of Struga

b.ciglovska@eust.edu.mk

МОЖНОСТИ ЗА УНАПРЕДУВАЊЕ НА ТРГОВИЈАТА СО ЗЕМЈОДЕЛСКИ ПРОИЗВОДИ НА ЗЕМЈИТЕ ВО РАЗВОЈ

АПСТРАКТ

Зошто земјоделството е важно за земјите во развој? За земји со мала урбана популација, зголемувањето на извозот на земјоделски производи може да го забрза растот многу повеќе отколку растечката побарувачка на домашниот пазар. Порастот на извозот значително допринесува за раст и развој на земјоделството преку обезбедување на готовински прилив за модернизирање на земјоделските практики и создавање на нови работни места. Досега, само ограничен број на земји во развој – како на пример Аргентина и Бразил можат ефективно да се натпреваруваат глобалниот пазар. Повеќето земји во развој се изоставени од извозниот бум и страдаат од негативните ефекти од зголемениот увоз, намалувајќи ги своите царини и поддршката за земјоделството.

Но сепак, земјите во развој имаат перспективи и можности за учество на меѓународните пазари преку искористување на тековниот стоков бум делумно поттикнат од побарувачката за агро-горива која ги држи цените на земјоделските производи на високо ниво.

Клучни зборови: *Трговија со земјоделски производи, земји во развој, можности, перспективи.*

ВОВЕД

Земјоделството има централна улога во обезбедувањето на храна и во процесот на намалување на сиромаштијата и гладот, како и голем придонес во националниот економски раст бидејќи, трговијата со земјоделски производи е значаен извор на девизен прилив за многу земји во развој¹.

Но и покрај тоа, треба да се има предвид и фактот, земјоделството самостојно не може да го постигне посакуваниот економски раст и развој на земјите и не може целосно да ги искористи можностите кои му ги нуди меѓународната трговска размена. Овој сектор неопходно е да биде поддржан и со соодветен степен на инфраструктурен, индустриски и технолошки развој на земјите.

Во тој контекст инвестициите (странски и домашни) можат да играат клучна улога во унапредување на земјоделското производство во земјите во развој, придонесувајќи за зголемување на продуктивноста и поддржувањето на економскиот развој.

Инвестициите се токму она што им недостасува на земјите во развој за да го унапредат развојот на земјоделскиот сектор, да го доближат своето земјоделство до светските стандарди, да го надминат ограничениот капацитет за извоз и да го искористат специјалниот и диференцијален третман кој го имаат во рамките на СТО во поглед на трговијата со земјоделски производи. На тој начин ќе ги искористат и бројните можности кои им ги нудат склучените регионални спогодби за слободна трговија, како и моменталната состојба во светот во поглед на обезбедувањето на храна и високите цени на земјоделските производи на меѓународниот пазар.

¹ World Investment Report, 2009

ЦЕНИТЕ НА ЗЕМЈОДЕЛСКИТЕ ПРОИЗВОДИ – МОТИВ И МОЖНОСТ ЗА УНАПРЕДУВАЊЕ НА ЗЕМЈОДЕЛСТВОТО ВО ЗЕМЈИТЕ ВО РАЗВОЈ

Доколку се направи еден осврт на состојбата на пазарите на земјоделски производи во годините наназад, ќе се утврди едно циклично движење на цените на истите и значителни промени и трансформации во земјоделските техники и системи. Според истражувањата направени од страна на ФАО², често пати на глобално ниво било доведувано во прашање обезбедувањето со храна, токму поради значителните варијации во цените и понудата на земјоделските производи. После Втората светска војна земјоделското производство значително се намалува, со што се појавува и недостиг на храна надополнет со последиците од сушите кои во втората половина на 40-те години на минатиот век ги зафаќаат Русија, Северна Африка и Далечниот Исток³. Во периодот пак на индустријализацијата, се врши директна дискриминација на земјоделството преку најразлични политики на заштита на индустриските производи и намалување на цените на земјоделските производи. Во овој период и намерно се одржуваат ниски цени на земјоделските производи со цел да се намали социјалната немаштина, а во текот на 50-те години на минатиот век се воведува и планирањето на земјоделското производство од страна на државата. Резултат на тоа е прекумерно производство и намалување на цените на земјоделските производи. Ваквата ситуација трае кратко време, бидејќи руралните општини се соочуваат со недостиг на средства, машини и други материјали за производство, кои проблеми надополнети со неповолните климатски услови доведуваат до значаен пад на земјоделското производство и недостиг на храна.

Во текот на 60-те години на минатиот век се случува „зелената револуција“ која повторно доведува до зголемување на обемот на земјоделското производство и појава на вишоци на пазарите, кои доведуваат до намалување на цените на земјоделските производи. Најголеми поволности од зелената револуција имаат потрошувачите поради ниските цени на земјоделските производи, кои се посебно поволни за сиромашните земји како нето

² <http://www.fao.org/docrep/x4400e/x4400e00.htm#TopOfPage>

³ Ibid

увозници на храна. 70-те години на минатиот век се карактеризираат со глобална економска нестабилност, девалвација на американскиот долар, рапиден пораст на цената на нафтата, дефицит на жито и рапидно зголемување на цените на земјоделските сировини. Во овој период светското земјоделство е погодено од енергетските кризи, инфлацијата, монетарната нестабилност, слабиот економски раст на развиените земји и глобалната несигурност, која ја надополнуваат неповолните климатски услови и кризите за храна во Африка.

Во текот на 80-те години на минатиот век се случува економската рецесија која во голема мера влијаеше на многу развиени земји и земји во развој и негативно се одрази на вкупниот земјоделски развој. Се намалува увозот на земјоделски производи, со што се намалува и цената и обемот на трговијата со истите. Масовната задолженост на земјите во овој период, ги приморува да го зголемат оној обем на производство кој е наменет за извоз и да го намалат увозот. Во текот на 1984 година се случува најголемата суша во Источна Африка, при што цените на некои производи како шеќерот, житариците и маслодајните семиња бележат рапиден пораст⁴. Порастот на цените продолжува и во почетокот на 90-те години на минатиот век, за да во втората половина се намалуваат под влијание на зголемената понуда како резултат на претходно високите цени и цените на супститутите, финансиските кризи во Азија, како и продолжителната поддршка на производството и извозот од страна на голем број земји.

Ниските цени на земјоделските производи имаа краткорочно позитивно влијание врз земјите во развој кои се јавуваат како нето увозници на храна, но сепак истите имаат негативно влијание врз домашното производство на овие земји и прашањето за обезбедување со храна. Во текот на 2001 година цените на земјоделските производи остануваат на ниско ниво, при што според податоците на ФАО, во периодот од мај 1996 година до јануари 2000 година индексот на цените на овие производи се намалува за 38%. Овој индекс се стабилизира во 2001 година за да во јануари 2002 година повторно се намали.

Во периодот од 2004-2006 година цените на земјоделски производи го достигнуваат своето највисоко ниво од средината на 90-те години на минатиот век, при што според

⁴ Ibid.

податоците на ФАО цените на маслите и маслата се зголемуваат за 63% во споредба со нивното ниво во периодот 2000-2001 година⁵. Ваквиот тренд се должи на порастот на побарувачката за земјоделски производи за производство на етанол и биодизел, како и растечката побарувачка од страна на брзорастечките економии како Бразил, Кина и Индија, зголемените цени на нафтата и таксите за поморскиот превоз исто создаваат притисок врз цените на земјоделските производи.

На страната на понудата пак, исто така влијаат зголемените цени на нафтата и хемиските средства кои се користат во земјоделското производство, кои доведуваат до стагнација на производството на земјоделски производи. Неповолните временски услови исто така дополнително го намалија обемот на земјоделското производство, што предизвика притисок врз цените на овие производи.

Почнувајќи од јули 2008 година, цените на земјоделските производи почнуваат да се намалуваат како резултат на новите состојби на страната на понудата и побарувачката. Имено, претходно високите цени доведоа до пораст на глобалното производство на земјоделски производи посебно во развиените земји и некои земји во развој (Бразил, Кина и Индија). Освен во овие три земји, во останатите земји во развој според анализите на ФАО, производството посебно на житата во периодот 2007-2008 година опаѓа, што укажува на фактот дека, високите цени на земјоделските производи не беа можност која можеа подеднакво да ја искористат мноштвото на сиромашни земјоделци во земјите во развој.

Друг фактор за намалување на цените е намалената побарувачка како резултат на глобалната финансиска криза која се случува во втората половина на 2008 година и растечката рецесија која ја намали економската активност на земјите. Но, и покрај падот на овие цени, побарувачката за биогорива сè уште останува силна поради намалувањето на цените на суровините и сè поголемото производство на етанол.

Производителите во земјите во развој во последните 50-тина години се соочуваа со вистински шокови на цените на земјоделските производи, при што периодите на високи меѓународни цени не беа во можност целосно да ги искористат. Повеќето од производителите во земјите во развој се многу далеку од случувањата на меѓународниот

⁵ The State of Food and Agriculture, FAO 2005, p.127

пазар, што значи дека зголемувањето на цените на земјоделските производи не значи и задолжително повисоки цени за сиромашните производители.

За да успешно ги искористат перспективите кои им стојат на располагање, земјите - во развој треба да обрнат посебно внимание и да вложат големи напори во следните области во насока на унапредување на земјоделскиот сектор:

- интензивирање на производството на основни земјоделски производи;
- интегрирање на луѓето и околината;
- проширување на улогата на пазарите;
- разновидност на основните жита;
- реформирање на економските политики и
- подобрување на квалитетот на земјоделските производи

За таа цел, постојани инвестиции во истражувањето и развојот се витални за земјоделскиот сектор во земјите во развој. Примената на науката и технологијата во развојот на земјоделството е важна детерминанта за успех, но не и доволна сама за себе. Неопходни се постојани и одржливи јавни инвестиции во компјутерска и софтверска опрема во земјоделството, како инвестиции во иригациони системи, рурални патни мрежи, рурално образование, пазарна инфраструктура и регулативни системи. Освен тоа потребни се и мотиви и иницијативи за инвестиции од страна на приватниот сектор, кој може да одговори на истите самостојно или колективно во соработка со своите партнери.

Тоа доведува до појава на „нови инвеститори“⁶ во земјоделството⁷, државите, меѓународните јавни институции, разните трговски куќи, странските инвеститори па дури и индивидуалните земјоделци, со цел обезбедување на храна за растечките популации и земјоделски сировини за новите индустрии. Тоа значи дека, земјите во развој денес ја добиваат клучната улога во обезбедувањето на светот со храна и со земјоделски сировини за нивна понатамошна преработка, бидејќи заедно со најмалку развиените земји се оние кои

⁶ Голем број компании како и владите на Кореја, Саудиска Арабија и ОАЕ инвестираат во земјоделско производство во странство, поради недостиг на обработлива површина и вода за наводнување.

⁷ World Investment Report, UNCTAD, 2009, p.93

сé уште располагаат со неискористена обработлива земја и доволно вода за спроведување на иригациони системи⁸.

ТНК И СДИ – ЗНАЧАЈНА ПЕРСПЕКТИВА НА ЗЕМЈОДЕЛСКИОТ СЕКТОР И ТРГОВИЈАТА СО ЗЕМЈОДЕЛКИ ПРОИЗВОДИ ВО ЗЕМЈИТЕ ВО РАЗВОЈ

Земјите во развој имаат бројни предизвици за промовирање и подобрување на земјоделското производство. Она што тие треба да го направат, е да создадат стратегија за привлекување на странските инвестиции и за активно учество на нивните главни носители -Транснационалните компании (ТНК), при што треба да ги земат предвид интересите на сите учесници, а посебно на локалните земјоделци и да овозможат нивно вклучување во процесот на донесување одлуки.

Земјите во развој треба да обезбедат и соодветна институционална поддршка. Земјоделските институции, како центрите за истражување и развој и кооперативите играат значајна улога во развојот на земјоделството, развојот на нови сорти на семиња и развојот на национален земјоделски план. Не треба да изостане и поддршката од владите на земјите преку обезбедување на соодветни инфраструктурни средства, како системи за наводнување, изградба на рурални патишта кои ќе го поврзуваат земјоделството со преработувачките капацитети и со пазарите, како и нивно понатамошно одржување.

Друг вид на поддршка можат да обезбедат преку технички тренинг и обука за подобро управување и користење на земјата и водата⁹. Поддршка може да се обезбеди и преку давање можност на ТНК да учествуваат во домашното земјоделско производство преку спроведување на странски директни инвестиции (СДИ) или преку склучување на договори во земјоделството, односно т.н. Договорно земјоделство (фармерство)¹⁰. Учесството на ТНК во земјоделските сектори на земјите во развој ќе овозможи

⁸ Ibid.

⁹ Ibid, p.100

¹⁰ Договорното фармерство сé повеќе се развива како значајна алтернатива на СДИ. Тоа се договорни аранжмани помеѓу земјоделците и филијалите на ТНК или агенти на ТНК, каде истите се согласуваат да им пренесат на ТНК определена количина на земјоделски производи по договорена цена, квалитет и стандарди, ден на достава и други специфичности. Договорното фармерство е посебно интензивно во многу растечки и сиромашни земји.

модернизација на земјоделското производство преку трансфер на современа технологија, знаења, вештини, спроведување активности на истражување и развој, воведување стандарди, подобрување на продуктивноста на работната сила, подобри сорти на семиња и ѓубрива и значајни иновации во земјоделството.

Во поглед на тоа, како денес се искористуваат можностите за инвестиции кои ги нудат ТНК, може да се истакне дека, почнувајќи од 2000 година па наваму, посебно зголемена атрактивност покажуваат регионите на земјите во развој, при што ТНК кои се вклучени во земјоделските активности се распространети во светот во над 110 земји во Африка, Азија, Океанија, Латинска Америка и Карибите, како и во економиите во транзиција на ЈИЕ и ЦИЕ кои се јавуваат како домаќини на СДИ во земјоделството¹¹. ТНК можат да се јават како производители, преработувачи на храна, продавачи на мало и на големо, трговци и добавувачи на сировини. Освен тоа, сè поголема важност која земјите во развој ја добиваа во глобалниот развој на земјоделското производство и трговијата со земјоделски производи, можат да ја искористат не само како земји домаќини во кои се остварува прилив на СДИ, туку и како земји инвеститори. Тоа претставува можност за земјите во развој да инвестираат во искористување на ресурсите во други земји, вложување во истражување и развој и во производство на потребните производи и нивно повторно враќање назад во земјата инвеститор.

Учеството на ТНК ќе овозможи создавање на поголема додадена вредност на земјоделските производи и зголемување на извозните приходи, но земјите во развој треба да бидат свесни дека, истите можат да имаат и некои негативни ефекти врз обезбедувањето со храна на земјата домаќин и недостаток на земја за локалните фармери. За таа цел се препорачува земјите домаќини да ги преземаат следните мерки и политики¹²:

- земјите во развој треба стратешки да го планираат земјоделското производство и прехранбената индустрија и да ја земат предвид улогата која ТНК можат да ја играат во имплементацијата на стратегиите;

¹¹ Во текот на 2008 година производителот на храна **Nestle** (Швајцарија) има склучено договори со над 600.000 земјоделци во преку 80 земји во развој и економии во транзиција, кои се директни добавувачи на разни земјоделски производи

¹² Ibid. P.190

- земјите во развој треба да посветат посебно внимание врз промоцијата на договорните врски помеѓу ТНК и локалните земјоделци за да го зголемат производниот капацитет и да ги искористат бенефициите;
- земјите во развој треба да утврдат дали ќе имаат бенефиции од интересот на земјите инвеститори за преземање на СДИ во производството на основна храна;
- треба да утврдат дали ќе имаат поголеми бенефиции од СДИ или од договорното фармерство и
- меѓународната заедница треба да го олесни пристапот на СДИ во земјите во развој преку намалување на увозните царини и нецаринските бариери и земјоделските субвенции во развиените земји, за да ги охрабри СДИ во сиромашните земји и треба да развие меѓународно признати правила и принципи за преземање на обработлива земја од странски инвеститори во земјоделското производство.

ТНК ќе овозможат земјите во развој да ги искористат своите компаративни предности, да постигнат извозна конкурентност, подобар пристап до странските пазари и зголемување на земјоделскиот извоз преку обезбедување на оние делови кои недостасуваат кај земјите во развој, како: брендирани имиња, развиени дистрибутивни канали и маркетинг и менаџмент вештини.

НОВИ ПОЛИТИКИ И РЕШЕНИЈА ЗА УНАПРЕДУВАЊЕ НА ЗЕМЈОДЕЛСКИОТ И РУРАЛНИОТ РАЗВОЈ

Земјите во развој во насока на унапредување на развојот на земјоделството, подеднакво внимание и напори треба да вложат и во руралниот развој. За таа цел се предлагаат следните политики и решенија¹³:

¹³ <http://www.vnep.org.vn/Modules/CMS/Upload/2/SUMARY%20CD%206-05.pdf>

1. Одржлив земјоделски и рурален развој – за оваа цел се потребни прилагодувања на политиките посебно политиката на употреба на земјоделските површини, политиките за развој на науката и технологијата и нивна примена во земјоделското производство и развој на останати политики за севкупен одржлив развој на земјите.

2. Развој на пазарната економија и меѓународна интеграција во земјоделството и руралната економија – тоа опфаќа развој на различни форми на деловно-производни организации и обезбедување на еднаквост помеѓу нив (државни претпријатија, колективи, приватни претпријатија, СДИ, приватни фарми и домаќинства). Сето тоа бара реформи во поглед на правната регулатива на овие организации и истите да се базираат на иста правна основа. Создавање на поволна бизнис клима, развој на врските помеѓу фазите во процесот на производство и процесот на потрошувачка, развој на различни видови на пазари во руралните области како, пазар на добра и услуги; пазар на капитал; пазар на недвижности, пазар на труд, пазар на наука и технологија и слично.

Промовирање на производни и деловни активности во руралните области во насока на зголемување на побарувачката за трансакции и развој на различните видови на пазари. Поддршка на меѓународната интеграција во земјоделството преку либерализација на трговијата со земјоделски производи со соодветни мерки кои ќе обезбедат најголеми бенефиции без обврска за членство во меѓународни спогодби и посебно зголемување на степенот на либерализација на извозот и увозот на оние производи кои имаат висока конкурентност. Притоа, условно и привремено штитејќи ги оние производи кои имаат средна конкурентска способност и примена на мерки за регулирање на понудата и цените за оние производи кои имаат ниска конкурентска моќ.

Поддршка на примената на оние нецарински мерки кои се дозволени од страна на СТО во земјоделството како СПС, мерки на заштита, анти-дампинг мерки, компензаторни мерки, мерки во врска со околината и други. Воведување на флексибилни цени и мерки за проширување на распространување на извозните пазари.

3. Развој на неземјоделските индустрии во руралните економии – изнаоѓање на национална стратегија за развој на неземјоделските индустрии во руралните области и врз нејзина основа изработка на планови и политики за развој на неземјоделски индустрии на

национално ниво¹⁴. За таа цел треба да се следат овие насоки: насока на индустриите, упатство за создавање на индустриски и комерцијални центри во руралните области и упатства за развој на пазарот.

ЗАКЛУЧОК

Сепак, иднината и перспективите на земјоделскиот сектор во земјите во развој и трговијата со земјоделските производи, во голема мера ќе зависи од резултатите и исходот од Доха рундата на преговори, кои неминовно ќе водат и до реформи во трговските политики на земјите, чии инструменти треба да влијаат врз решавањето на проблемите со кризите за храна, рапидниот пораст на цените, континуираното високо ниво на заштита на земјоделскиот сектор во развиените земји и прашањето за понатамошната либерализација на меѓународната трговија со земјоделски производи. Во таа насока земјите во развој треба да определат цврста позиција во рамките на тековната рудна преговори од која ќе ги бранат своите интереси и ќе издејствуваат мерки за унапредување и олеснување на нивниот развој. Меѓу другото, треба да се залагаат за примена на безбедносните мерки за заштита на своите пазари од увозните бранови, преку воспоставување на шеми за контрола на понудата и уредни маркетинг механизми.

Земјоделскиот сектор не е единствен сектор во економијата на една земја и не е моќен во толкава мера индивидуално да ги искористи бенефициите кои ги нуди меѓународната трговија и истите да ги насочи кон намалување на сиромаштијата и зголемување на економскиот развој. Индустрискиот сектор е оној сектор кој може да биде суштински услов за унапредување на земјоделскиот сектор, преку дополнителни инвестиции во земјоделството, обезбедување на основна инфраструктура, внесување на нова технологија и зголемување на продуктивноста и квалитетот на земјоделското производство.

¹⁴ http://www.momagri.org/UK/editorials/Doha-round-will-not-prevent-another-food-crisis_454.html

БИБЛИОГРАФИЈА

1. A. P. Thirluall, *Economic Research paper No.63*, University of Kent, Canterbury;
2. A.Guuria, P.Lamy, S.Panichpakdi, Report on G 20, Trade and investment measures, 14 september 2009;
3. A.Hoda, A.Gulati, The modalities on which developing countries can rely in WTO agriculture negotiations, IFPRI, 2008;
4. A.Thirlwall, Trade, Trade liberalization and Economic growth:Theory and evidence, Economic research paper No.63, The African Development Bank, 2000;
5. FAO Papers on Selected Issues Relating to the WTO Negotiations on Agriculture; FAO, Rome, 2002;
6. Food and Agriculture Organization (ФАО) *Agriculture and Consumer Protection Department*. 2001;
7. The Future of preferential Trade Arrangements for Developing Countries and the Current Round of WTO negotiations on Agriculture; Stangermann Stefan, ФАО, Rome, 2002;
8. World Investment Report, UNCTAD, 2009.

Веб Страници:

1. http://ec.europa.eu/agriculture/publi/peco/slovenia/summary/sum_en.htm;
2. <http://web.worldbank.org/WBSITE/EXTERNAL/NEWS/0,,contentMDK:22394354~pag;ePK:64257043~piPK:437376~theSitePK:4607,00.html>;
3. <http://www.freetrade.org/pubs/freetotrade/chap2.html>;
4. [http://www.ФАО.org/docrep/46140e/46140e04.htm#с\)%20international%20trade%20in%20agricultural%20products](http://www.ФАО.org/docrep/46140e/46140e04.htm#с)%20international%20trade%20in%20agricultural%20products).

PhD. Dashmir NASUFI

International University of Struga

d.nasufi@eust.edu.mk

MËNYRAT E NJOFTIMIT PËR KRYERJEN E VEPRËS PENALE

ABSTRAKT

Me këtë punim shkencor kemi për qëllim që të ndihmojmë me idetë dhe rekomandimet tona organet shtetërore (polici dhe prokurori) për t'u njohur më mirë me mënyrat e njohjes për kryerjen e veprave penale. Njëherit me anë të punimit tonë dëshirojmë që të ngrejme vetëdijen e opinionit dhe t'i ndihmojmë me ide dhe mënyra se si të bëjnë njohtimin për kryerjen e veprave kriminale.

Në çdo situatë, kriminalisti duhet të jetë këmbëngulës në përcaktimin e identitetit të trupit të pa jetë të personit të panjohur, sepse me përcaktimin e identitetit zgjidhen shumë të panjohura. Metodika e zbulimit, sqarimi dhe dëshmimit të vrasjeve (në qoftë se bëhet fjalë për vdekje të dhunshme) niset pikërisht nga identifikimi i trupit pa jetë.

Motivet e anonimitetit ose pseudonimitetit janë të rëndësishme për kriminalistët sepse ato janë udhëtrues për gjetjen e autorëve. Fajsimet e rrejshme mund të jenë vepra penale të caktuara, për shkak se u shkaktojnë njerëzve ndjenja të pakëndshme. Për më tepër personat e paraqitur mund të jenë të panjohur për paraqitësin.

Lidhur me njoftimin e veprave penale ka mënyra të ndryshme, por duhet të theksojmë se hasen vështirësi të shpeshta në mënyrë të veçantë në Republikën e Maqedonisë për njoftimin e veprave penale që janë më të ndjeshme (përdhunimet) për arsye se ligji kërkon që gjatë dhënies së informacionit duhet viktima ose dëshmitarët të identifikohen për procedurë të mëtejshme me

qëllim të zbulimit të plotë të rastit. Kjo i bën njerëzit konfuz lidhur me njoftimin në organet kompetente. Rol tjetër luan edhe mentaliteti sidomos në fshatra, që për të ruajtur reputacionin e familjes ose vetë viktimës, në të shumtën e rasteve ngurohet që të bëhet paraqitja e rastit kriminal.

Nga ana tjetër edhe disa vepra penale (vjedhjet e xhepave, vjedhjet e imta) në të shumtën e rasteve nuk paraqiten pasi viktimat ndjehen të turpëruar se si kanë arritur kryerësit e kësaj vepre të kryejnë vjedhjen ose në raste tjera kur viktimat nuk ndjehet shumë i demtuar për të paraqitur rastin penal.

Rekomandojmë që të punohet më shumë me opinionin në këtë sferë me anë të programeve të ndryshme kombëtare, seminare, nëpërmjet medimeve që njerëzit të vetëdijsohen dhe t'a kuptojnë që çdo vepër penale është e dënueshme dhe nuk është turp që viktimat të paraqesë rastin kriminal dhe në këtë mënyrë të kontribuohet në luftën kundër kriminalitetit. Edhe institucionet përkatëse të veprojnë me shpejtësi dhe me dënime gjegjëse sipas Kodit Penal. Kjo arrihet vetëm duke depolitizuar dhe dekriminalizuar këto institucione.

Fjalë kyçe: *Vepër penale, njoftim, kriminalist, dëshmitar.*

HYRJE

Njoftimi me kohë për kryerjen ose përgatitjen e veprës penale duhet të jetë një prej detyrave më të rëndësishme të organizative taktike të policisë. Do të ishte gabim i madh në qoftëse policia do të orientohej kryesisht në vepra penale dhe në ngjarjet, pasojat e të cilave janë të dukshme. Në raste të tilla policisë do ti bëheshin me të drejtë vërejtje se nuk është operative dhe dinamike, sepse në të shumtën e rasteve ajo do të njoftohej për kryerjen e veprave penale nga të dëmtuarit apo dëshmitarët, kurse më rrallë do të njoftohej nëpërmjet punës së saj operative.

Për këtë arsye, të gjithë policitë synojnë që të jenë operative e dinamike në punën dhe aktivitetet e tyre për sigurimin e informacioneve për kryerjen ose përgatitjen e veprave penale. Përvoja ka treguar se burimi kryesor i informatave janë qytetarët që janë palë e dëmtuar nga veprat penale apo ata që paraqiten në ndonjë cilësi tjetër, por më së shpeshti qytetarët që janë dëshmitarë të ngjarjeve kriminale.

Prandaj, në punën e saj të përditshme, policia duhet të synojë të fitojë besimin e qytetarëve, të cilët janë burimi me i shpeshtë i njoftimeve, si për veprat penale të kryera ashtu edhe për veprat penale që janë në përgatitje e sipër.

Duhet të theksohet fakti se njoftimet dhe informacionet që merren nga qytetarët dhe nga burimet tjera duhet të verifikohen në mënyrë të papërshtatshme, derisa të vërtetohet saktësia e tyre. Në këtë punim do të ndalemi në mënyrat e njoftimit të policies konkretisht për vrasjet.

Policia informohet për to në këto mënyra: Nëpërmjet njoftimeve mbi zhdukjen e personave, vetë paraqitjeve, thashethemeve publike, personave të besueshëm, njoftimeve anonime e me pseudonime, aktivitetit vetjak të policisë, njoftimit të qytetarëve dhe personave zyrtarë, fakteve indikative, zbulimit të trupave pa jetë e mbetjeve të tyre si dhe mediave publike.

1.PARAQITJET PËR ZHDUKJEN E PERSONAVE

Pikë fillestare e aktivitetit të policisë, kur bëhet fjalë për zhdukjen e ndonjë personi, mund të jetë deklaratë e ndonjërit prej familjarëve e të afërmeve, ndonjë miku, qiradhënesi, eprori etj. Zhdukja e ndonjë personi nuk do të thotë se ka ndodhur ndonjë vrasje, prandaj merren parasysh situata të ndryshme jetësore. Këto mund të jenë situata të llojllojshme, siç janë:

- Arratisja e të miturve ose e të rriturve për motive të ndryshme,
- Vetëvrasja që nuk është zbuluar ende,
- Vdekja e papritur diku në një vend të vetmuar,
- Ikja për shkak të ndonjë mospërfundimi apo dështimi ose për shkak të ndonjë vepre penale,
- Aventurizmi i të rinjve dhe adoleshentëve,
- Humbja e të moshuarve për shkak të dobësisë apo humbjes së mbamendjes (amnezia),
- Largimi i të sëmurve psikikë nga vendbanimi i tyre,
- Fshehja për shkak të kryerjes të ndonjë vepre penale, etj.

Ne përmendëm vetëm disa prej rasteve që duhet të kihen parasysh me rastin e planifikimit të procedurës parapenale, në mënyrë që të eliminohen verzionet e përmendura dhe verzionet tjera, të cilat nuk kanë të bëjnë me vrasje kur të vërtetohet se në rastin e caktuar nuk qëndron asnjëra prej

këtyre versioneve, mund të merret parasysh versioni për vrasjen dhe të fillojë përpunimi përkatës kriminalistik. Në këtë rast janë të rëndësishme dy momente:

1.Kur (pas njoftimit për zhdukjen e personit) rrethanat dhe vlerësimi i rrezikut të zhdukjes tregojnë se mund të bëhet fjalë për vrasje; dhe

2.Kur të gjendet trupi pa jetë ose mbetje e tij, në bazë të të cilave mund të përcaktohet identiteti.

Me rastin e marrjes të njoftimit, policia siguron të dhënat themelore: kush e ka bërë njoftimin për zhdukjen e personit, të dhënat identifikuese të personit të zhdukur, përshkrimi dhe fotografia, koha dhe vendi ku është parë për herë të fundit si dhe rrethanat në të cilat është parë, gjendja fizike dhe psikike e personit të zhdukur, vendet eventuale ku mund të ketë shkuar personi i zhdukur (familja, miqtë, objektet hotelerike, etj), verifikimi se është larguar më parë, gjendja familjare, arsyet dhe motivet eventuale të largimit, etj¹.

1.1. Vetëparaqitja

Janë të rralla rastet e vetëparaqitjes, por ndonjëherë ndodh që persona të caktuar të paraqesin vetë kryerjen ose pjesëmarrjen e tyre në kryerjen e veprës penale. Vetëparaqitja është e mundur në këto situata:

1. Kur vetëparaqitja është e vërtetë;
2. Kur vetëparaqitja është e vërtetë e pasigurtë (vetëparaqitësi është një lajthitje)
3. Kur vetëparaqitja është e rrejshme (e pa vërtetë objektive dhe subjektive).

Vetëparaqitjet e vërteta: zakonisht bëhen nga persona që e kryejnë veprën penale në afekt ose pa dashje, derisa ata gjenden ende nën ndikimin psikik të veprës penale. Vetëparaqitjen e vërtetë mund ta bëjë edhe kryesi i veprës penale që mendon se do të zbulohet, në mënyrë që t'i lehtësohet pozita në procedurën penale, por këtë mund ta bëjë edhe kryesi i veprës penale që dëshiron të fshehë ndonjë vepër më të rëndë, ndonjë bashkëpjesmarrës ose ndonjë organizatë të

¹ Dr.Ragip Halili, "Kriminologjia", botimi i gjashtë.

cilës i përket. Vetëparaqitja, si për veprat që nuk janë kryer ashtu edhe për vepra që janë kryer nga dikush tjetër, bëjnë si personat e shëndoshë psiqikisht ashtu edhe personat e sëmurë psiqikisht.

Vetëparaqitja e rrejshme mund të jetë poteza taktike që bëhet me qëllim që gjithë procedurat të orjentohen në drejtim të gabuar. Në këso rastesh duhet të verifikohen me kujdes besueshmëria e të gjithë deklaratave dhe dëshmime të grumbulluara. Ndonjëherë është e nevojshme që personit që bën vetëparaqitje të rrejshme ti merret e ashtuquajtura "*Dëshmi e agimit*", t'i thuhet të bejë rekonstrukcionin e ngjarjes, ti thuhet të bëjë skicka të vendit të ngjarjes, të mënyrës së kryerjes së veprës, të pozitës së tij dhe të pozitës së viktimës, etj.

Përmbajtja e vetëparaqitjes gjithnjë duhet të krahasohet me konstatimin e përcaktuar objektiv e subjektiv. Personat e shëndoshë psiqikisht bëjnë vetëparaqitje të rrejshme për arsye të ndryshme, si psh: që të fshehin ndonjë vepër më të rëndë penale. Ndonjëherë, paraqitja e rrejshme e vendit të kryerjes së veprës (*corpora delicti*) bëhet nga shpresa se vetëparaqitësit se gjatë udhëtimit deri në vendin e imagjinuar do të ketë mundësi të arratiset.

Paraqitja e rrejshme mund të bëhet edhe nga qëllime fisnike, siç janë: *mbrojta e fëmijëve, prindërve, bashkëshortit, të dashurit*, etj. Por, kjo mund të bëhet edhe për motive ekonomike, ashtu që kryesi i vërtetë (më i ri e më i fuqishëm apo ekspert) të jetë i lirë dhe të vazhdojë të punojë. Vetëparaqitja e rrejshme mund të bëhet edhe për shkak të trupit, si edhe për shkak të problemeve psikologjike. Nëse ndodh ndonjë vepër sansacionale e psikopatit nga dëshira për publicitet dhe sensacion, kjo vepër vetëparaqitet. Poashtu, vetëparaqiten edhe personat histerikë. Gënjeshtarët psikologjikë (mitomanët, *pseudologia phantastica*) kanë imagjinatë të gjallë dhe të bujshme dhe krijimet e tyre paraqiten si realitet. Gënjeshtari (konfabulatori) shpesh di të gënjejë, duke besuar se gënjeshtria e tij është e vërtetë. Vetëparaqitjet e rrejshme shfaqen edhe në gjendje të delirit të etheve, në gjendje të dehur, të helmimit me dioksid karboni, etj. Si rregull, vetëparaqitjet e rrejshme zbulohen ashtu që paraqitja nuk përputhet me faktet (dëshmitë) tjera të vërtetuara gjatë procedurës. Vetëparaqitja e personave me sëmundje shpirtërore është dukuri mjaft e shpeshtë. Kjo është pothuajse dukuri tipike te disa lloje sëmundjesh shpirtërore si melankolikët, skizofrenët, oligofrenët, paranoikët, epileptikët, të sëmurët nga depresioni, paralitikët progresiv dhe alkoolistët janë të prirur për vetëparaqitje.

1.2. Thashethemet publike

Në shkencën kriminalistike kjo formë e njoftimit të veprës penale quhet përhapje e lajmit (fama est) për ndonjë vepër penale ose për persona të caktuar si kryerës të asaj vepre, ndërsa nuk dihet se a është njoftimi i saktë dhe cili është burimi i tij. Gjatë përhapjes lajmi ndryshon gjithnjë e më shumë (trasnsormohet) kështu që me kohë ai ndryshon më shumë apo më pak ose plotësisht. Thënë ndryshe, njoftimi arrin i deformuar deri te policia. Por, pavarësisht nga vërtetësia ose jovërtetësia e lajmit që përhapet me thashetheme publike organet represive, para se gjithash policia, janë të obliguara që të ndërmarrin masat përkatëse të drejtimit të gjetjes të burimit të thashethemeve dhe në drejtim të verifikimit të përmbajtjes së lajmit që qarkullon. Ky lajm është sinjal se ata duhet të reagojnë. Si rregull, burim i thashethemeve është mjaft vështirë të gjendet.

Shpesh bëhet fjalë për të ashtuquajturit "*Dëshmitar anonim*". Këta janë personat për gjetjen nëpërmjet thashethemeve që qarkullojnë mbi ndonjë ngjarje apo vepre penale, për të cilën nuk dihet. Një kriminalist autoritativ në kohën e tij kishte deklaruar se thashethemet janë si një gurr i hedhur në ujrat e qeta. Gurri zhytet dhe është vështirë ta gjejmë, kurse rrathet koncentrik të valëve zgjërohen nga vendi ku ka rënë gurri. Në rastin e thashethemeve publike, organet e represionit reagojnë sipas thënies popullore "*Ku ka tym ka edhe zjarr*".

1.3. Personat e besueshëm

Kur bëhet fjalë për trupat represivë, sidomos për policinë, burim i shpeshtë i njohurive për ekzistimin e veprave penale dhe të kryerësve të tyre janë personat e besueshëm, besnikët, informatorët. Në kuptimin e gjërë të fjalës, informatori është kategori kriminalistike taktike e personave të cilët polica i shfrytëzon përkohësisht ose vazhdimisht, por gjithmonë në mënyrë sekrete, për marrjen e informacioneve që janë të rëndësishme për kriminalistët. Këto informacione kanë të bëjnë me vepra penale që planifikohen ose kryhen, për autorë të tyre, për bashkëpjesmarrës, etj.

Ky institut taktik kriminelistik është i lidhur me të gjitha llojet e observimeve speciale të policisë, siç janë mbikqyrja sekrete, vendosja e grackës, etj. Si rregull nocioni përmbledhës i informatorëve përfshin: informatorët, besnikët, vigjilentët, provokatorët, hetuesit e fshehtë (zbuluesit), agjentët sekret, etj. Informatorët mund të jenë qytetarë të dënuar më parë ose të padënuar ndonjëherë.

Në kuptimin e ngushtë, informator është çdo person që është i gatshëm të bashkëpunojë në mënyrë të fshehtë me policinë ose me trupat e tjerë represivë që janë të angazhuar në zbulimin, sqarimin dhe parandalimin e veprave penale.

1.4. Paraqitjet anonime dhe me pseudonime

Paraqitja anonime është paraqitja pa shenja e paraqitësit (pa nënshkrim, të dhëna personale, etj). Paraqitjet me pseudonime janë ato paraqitje që kanë të dhëna ose nënshkrim të rrejshëm të paraqitësit. Këto paraqitje mund të jenë të shkruara me dorë ose me makina, kompjuter, në disketa, etj. Mund të ndodhë ato të paraqiten edhe në mënyrë gojore, me telefon.

Paraqitjet anonime, sikur edhe ato me pseudonime, janë të rëndësishme për shkak të përmbajtjes së tyre dhe jo për shkak se nuk kanë autorësi. Përmbajtja e këtyre paraqitjeve mund të jetë e vërtetë, pjesërisht e vërtetë ose e rrejshme. Edhe paraqitjet anonime (denoncimet), sikurse edhe paraqitjet me pseudonim, duhet menjëherë të verifikohen, për shkak të përmbajtjes së tyre. Nëse konstatohet se të thënat janë të sakta ose pjesërisht të sakta bëhet gjurmimi i paraqitësit.

Këto paraqitje janë dukuri psikologjike e ndonjëherë edhe psikopatologjike. Motivët e paraqitësve mund të jenë të ndryshme, si psh mbrojtja e miqve. Por, të tilla mund të jenë edhe paraqitjet e vonimeve seksuale, për shkak të problemeve shoqërore që mund të kenë paraqitësit. Ndonjëherë deliktet seksuale mund të jenë edhe të rrejshme. Gratë hysterike shpesh bëjnë paraqitje të rrejshme anonime, sidomos në fazat kur kanë probleme funksionale seksuale (menstruacionet, shtatzania, lehonja, laktacioni, klimaksi). Nëse nëpërmjet paraqitjeve anonime ose pseunonimeve.

Motivët e anonimitetit ose pseudonimitetit janë të rëndësishme për kriminalistët sepse ato janë udhtregues për gjetjen e autorëve. Fajsimet e rrejshme mund të jenë vepra penale të caktuara, për shkak se u shkaktojnë njerëzve ndjenja të pakëndshme. Për më tepër, personat e paraqitur mund

të jenë të panjohur për paraqitësin. Ndonjëherë mund të bëhet fjalë për "psikozë" ose "infeksion" të paraqitjeve anonime, sidomos në kohë lufte ose në kohë krizash politike apo ekonomike.

Qëllimi i paraqitjes anonime ose pseudonime mund të jetë edhe vështirësimi ose zgjatja e një procesi që vazhdon. Zbulimi i autorëve të këtyre paraqitjeve është i vështirë veçanërisht kur bëhet fjalë për paraqitje anonime, ose me pseudonim që bëhen nëpërmjet shkronjave dhe numrave të prerë nga gazetatat ose që janë shkruar nga një person gjysem analfabet. Poashtu, është i vështirë edhe zbulimi i paraqitjeve, autorët e të cilëve nuk i përkasin rrethit jetësor të personit të paraqitur.

1.5. Aktiviteti vetiak i policisë

Gjatë kryerjes së punëve të saj të rregullt, policia ka detyra shumë të rëndësishme dhe të shumëllojshme, si për parandalimin ashtu edhe për represionin ndaj veprave penale, sepse me ndihmën e masave represive dhe preventive, policia merr vesh për vepra penale të kryera ose të planifikuara.

Kur bëhet fjalë për masa preventive kihen parasysh të gjithë llojet e njoftimeve për dukuritë e rrezikshme shoqërore, për shkaqe dhe pasoja të këtyre dukurive. Këtu bëjnë pjesë edhe masat e mbikqyrjes ose vëzhgimit të lëvizjes dhe veprimit të personave me histori kriminale dhe personave me sjellje asociale, pastaj veprimtaria e përditshme patrulluese, prita, racia, etj. Disa prej këtyre aktivitete të policisë, përveç karakterit preventiv, mund të kenë edhe karakter represiv kështu që mund të quhen edhe masa preventive represive².

Në rastet kur policia, gjatë kryerjes së detyrave të saj, vëren se është kryer ndonjë veprë penale, ajo e njofton sa më shpejtë qendrën operative, e cila do të koordinojë aktivitetet e sektorëve të tjerë të policisë dhe të vetvetes.

1.6. Paraqitjet e qytetarëve dhe personave juridik

Kodi i procedurës penale (neni 199 al.1) parashikon që paraqitja t'i dorezohet prokurorit publik kompetent në formë të shkruar, nëpërmjet mjeteve teknike të komunikimit gojarisht. Sipas dispozitës të alinesë 2 të këtij neni, "*nëse vepra penale paraqitet gojarisht, paraqitësit i tërhiqet*

² Xh. H. Retklif, Mendimi strategjik për zbulimin e kriminalitetit, Tabernakul, Shkup, 2009

vërejtja për pasojat e bërjes së rrejshme të paraqitjes penale. Paraqitja gojore futet në proces verbal, ndërsa ajo bëhet nëpërmjet telefonit ose mjeteve të tjera teknike të komunikimit hartohet shkresë zyrtare".

Sipas dispozitës së alinesë 3 të nenit të lartëpërmendur, nëse paraqitja i dorëzohet gjykatës, policisë ose prokurorit publik kompetent, ajo pranohet dhe menjëherë i përcillet prokurorit publik kompetent. Paraqitje penale konsiderohet njoftimi se është kryer apo është tentuar të kryhet ndonjë veprë penale që ndiqet sipas detyrës zyrtare dhe evuantualisht njoftimi për kryesin e kësaj veprë. Në ligj nuk egziston definicioni për kallëzimin penal, por vetëm rregullohet procedura e përgatitjes të dorzimit të tij si dhe veprimi i trupave kompetente në bazë të tij. Kallëzimi penal, parimisht është i liruar nga forma procesore. Ai mund të bëhet në mënyrë gojore, me shkrim, me telefon, me telegraf, me teleprinter, e-mail, ose nëpërmjet mjeteve tjera të telekomunikimit por edhe nëpërmjet regjistrimeve teknike (kasetave, disketave, cd etj). Nëse paraqitësi kërkon që kallëzimi të ketë karakter sekret, kjo duhet të respektohet kur është e mundur në bazë të parimit të diskrecionit.

Kallëzim mund të bëjnë fëmijët e mitur dhe personat e rritur. Kur bëhet fjalë për kallëzim të fëmijëve dhe të miturve rregullat e kriminalistikës kërkojnë që të kontaktohet me fëmijet ose kujdestarët e tyre përveç në rastet ku përmbajta e veprimit kriminal nuk ka të bëjë me ta.

Nëse paraqitja merret gojarisht ose me telefon ajo duhet të pranohet, të protokollohet dhe të verifikohet në pajtim me pyetjet e arta. Paraqitësi duhet të pyetet për personalitetin e kryesit, sepse organi procedural duhet të krijojë bazën faktike për vlerësimin e gjithanshëm të të dyshuarit (të dhënat jetësore, dënimet eventuale të mëparshme, autoritetin, karakterin, motivet eventuale dhe qëllimet e kryerjes së veprës penale ose edhe të mosekzistimit të veprës penale). Me grumbullimin e sa më shumë të dhënave mbi kriminogjenezën duhet të grumbullohen edhe të dhëna të hollësishme mbi viktimogjenezën. Është e nevojshme të përcaktohen edhe motivet e paraqitjes së veprës penale, sepse ato bëjnë pjesë në bazën faktike për verifikimin e vartësisë së përmbajtjes së paraqitjes dhe për planifikimin e procedurës. Sa herë që është e mundur, me paraqitësin duhet të dilet në vendin e ngjarjes dhe të verifikohet me kujdes se a përputhen të thënat në paraqitje në gjendjen e hasur në vendin e ngjarjes dhe se a egzistojnë kundërthënie midis paraqitjes së mëparshme të paraqitësit dhe paraqitjes së dhënë në vendin e ngjarjes. Paraqitja e bërë në vendin e ngjarjes është e besueshme dhe, si rregull ajo do të duhej të ishte e besueshme.

Në nenin 197, al.1 të KKP të Kosovës është parashikuar që *"të gjitha organet publike janë të obliguara të paraqesin veprat penale që ndiqen sipas detyrës zyrtare për të cilat janë informuar ose për të cilat kanë marrë vesh në ndonjë mënyrë apo në ndonjë tjetër"*.

Ndërkaq, në al.2 të të njëjtit nen është parashikuar që *"me rastin e paraqitjes së kallëzimit penal, organet publike të alinesë 1 të këtij neni paraqesin dëshmitë që i kanë të njohura dhe ndërmarrin hapa për ruajtjen e gjurmëve të veprës penale, mjeteve ndaj të cilave është kryer vepra penale ose me të cilat është kryer vepra penale, si edhe dëshmime tjera"*.

Në nenin 199 al.2 parashikohet që *"nëse vepra penale paraqitet gojarisht, paraqitësit të saj i tërhiqet vërejtja për pasojat e paraqitjes së kallëzimit të rrejshëm penal. Paraqitja gojore futet në proces verbal, ndërsa kur paraqitja bëhet në telefon ose nëpërmjet mjeteve tjera teknike të komunikimit, hartohet shkresa zyrtare"*.

Shtrohet problemi kur paraqitja e ndonjë veprë të rëndë penale i bëhet subjektit juridik dhe jo personave zyrtar të autorizuar. Kjo bëhet problem si për shkak të mungesës së përgatitjes profesionale të personelit që e pranon paraqitjen, ashtu edhe për shkak të mungesës së paisjeve adekuate teknike të këtyre subjekteve kështu është e mundur që të krijohet situatë kur subjekti juridik shtron pyetjen *"Çka të bëj nëse me telefon kërcënohem me bombë?"*. Kjo çështje e cila në shikim të parë duket e thjeshtë, është shumë komplekse në realitet, jo vetëm për shkak të përmbajtjes, por edhe për shkak të vetë procedurës *"Si të veprohet në këtë situatë ?"*.

1.7. Faktet indikative

Një prej formave për inçizimin e procedurës parapenale është zbulimi i fakteve të caktuara indikative, të cilat tregojnë egzistimin e veprës penale - vrasjes. Kështu psh në ndonjë vend gjendet ndonjë njollë gjaku, ndonjë pjesë e përgjakur e veshëmbathjes apo, natën dëgjohet ndonjë britmë, thirrje për ndihme etj.

Praktika kriminalistike tregon se ka raste të shumta që vrasësit i kanë mbajtur me ditë e me javë në banesat e tyre trupa të pajetë të viktimave, kështu që kundërmimi i tyre i ka shtyrë fqinjët ose kalimtarët e rastit të njoftojnë policinë, kështu që ka filluar zbulimi i krimeve të kryera.

2. ZBULIMI I TRUPIT TË PAJETË OSE I MBETJEVE TË TIJ

Një mënyrë e shpeshtë e zbulimit të vrasjeve është zbulimi i trupit të pajetë ose i mbetjeve , gjë që ka çuar në fillimin e procedurës parapenale .

Do të përmendim disa prej situatave që tregojnë se ku mund të zbulohen trupa të pajetë apo mbetje të tyre:

1.Trupa pa jetë ose mbetje të tyre janë gjetur në shtëpitë e personave të vrarë ose në ndonjë vend tjetër ku viktimat ka shkuar rastësisht , është ftuar ose i është përgatitur ndonjë kurth, prandaj kryesi i vrasjes përpiqet të pamundësojë përcaktimin e identitetit.

2.Trupa pa jetë ose mbetje të tyre janë gjetur në banesa të viktimave, zakonisht, në situata kur nuk shtrohet çështja e identitetit , por duhet të orjentohejmë në çështjen se a bëhet fjalë për vrasje apo për ndonjë shkak tjetër të vdekjes.

3.Trupa pa jetë ose mbetje të tyre janë gjetur në shtëpitë që nuk kanë qënë të viktimave por në të cilat nuk janë kryer vrasjet, por aty janë dërguar pas kryerjes së vrasjes. Kjo situatë mund të komplikojë hetimet për zbulimin e kryesit, sepse nuk dihet vendi i kryerjes së krimit dhe, shpesh, shfaqet edhe problemi i identitetit të viktimës. Praktika kriminalistike ka treguar se gjithnjë deri sa nuk zbulohet vendi i kryerjes së vrasjes dhe identiteti i viktimës, procesi i hetimeve zhvillohet si nëpër terr.

Trupa pa jetë ose mbetje të tyre janë gjetur edhe në arkivole, në valixhe etj.

Këto situata tregojnë se kryesi i vrasjes ka pasur për qëllim ta fshehtë vrasjen duke e përgatitur trupin pa jetë si të tërë ose të coptuar, t'a hedhë në blloqet e betonit në ndërtim, në objektet e braktisura, në deponi të mbeturinave etj. Kështu kryesi i vrasjes përpiqet të pamundësojë përcaktimin e lidhjes midis tij dhe vrasjes së kryer. Përvoja e veprës penale përpiqet të mundësojë identifikimin e viktimës duke humbur të gjitha gjurmët që mund të shërbejnë si bazë për identifikim, duhet të nxirret përfundimi i çmuar se midis kryesit të vrasjes dhe viktimës ka egzistuar ndonjë lidhje dhe se me zbulimin e kësaj lidhjeje mund të gjendet kryesi i vrasjes. Kjo nuk do të thotë se është gjithmonë kështu, por kjo është një indikacion i çmueshëm orjentues eliminues.

Në situata kur nuk haset në trup të pajetë, por në disa pjesë të trupit të pa jetë prej të cilit nuk mund të bëhet trupi i tërë, identifikimi i viktimës është më i vështirë. Dikur kjo ka qënë shumë

e vështirë, por sot egziston mundësia e identifikimit nëpërmjet analizës së ADN-së. Identifikimi është më i lehtë nëse policia e ka mostrën e pjesëve të trupit të pa jetë dhe atë të personit që kërkohet. Për të vazhduar përpunimin e suksesshëm kriminalistik, detyrë kryesore e kriminalistit është identifikimi i trupit të pa jetë.

Një prej çështjeve kryesore që shtrohen si para kriminalistit ashtu edhe para vrasësit është ajo se a mund të lirohet vrasësi nga trupi i pa identifikuar. Për vrasësin shtrohet problemi si ta fsheh përgjithmonë trupin pa jetë. Do të përmendim disa prej përpjekjeve që trupi i pa jetë të azgjësohet ose të fshihet përgjithmonë. Disa prej përpjekjeve të tilla janë: Hedhja e trupit të pa jetë në ujë, copëtimi, kallja, përdorimi i materieve kimike në trupin e pa jetë, hedhja e trupit e pa jetë e kafshëve, psh qenve.

3.MEDIA MASIVE

Këto janë mjete të komunikimit me publikun të cilët janë mjete të thjeshta dhe të shpejta të komunikimit. Personat me histori kriminale, sidomos me kriminalitet të organizuar, jo rrallë i shfrytëzojnë mediat masive për dërgimin e mesazheve të koduara, në formë të ndryshme të reklamave, ofertave, shpalljeve, artikujt të ndryshëm etj.

Policët bashkëkohore, sikur edhe shërbimet informative, kanë njësi ose sektorë të veçantë për përcjelljen e mediave masive. Ndonjëherë porositë e kriminelëve janë të koduara, kështu që është e nevojshme të bëhet dekodimi i tyre. Në ditët e sotme mediat masive, sidomos interneti, shfrytëzohen gjithnjë e më shumë për zbulimin e personave të zhdukur, trafikut të qënieve njerëzore, prostitucionit, pedofilisë, etj.

KONKLUZION

Lidhur me njoftimin e veprave penale ka mënyra të ndryshme, por duhet të theksojmë se hasen vështirësi të shpeshta në mënyrë të veçantë në Republikën e Maqedonisë për njoftimin e veprave penale që janë më të ndjeshme (përdhunimet) për arsye ligji kërkon që gjatë dhënies se informacionit duhet viktimat ose dëshmitarë të identifikohet për procedurë të mëtejshme me qëllim të zbulimit të plotë të rastit. Kjo i bën njerëzit konfuz lidhur me njoftimin në organet kompetente.

Rol tjetër luan edhe mentaliteti sidomos në fshatra, që për të ruajtur reputacionin e familjes ose vetë viktimës, në të shumtën e rasteve ngurohet që të bëhet paraqitja e rastit kriminal.

Nga ana tjetër edhe disa vepra penale (vjedhjet e xhepave, vjedhjet e imta) në të shumtën e rasteve nuk paraqiten pasi viktimat ndjehen të turpëruar se si kanë arritur kryerësit e kësaj vepre të kryejnë vjedhjen ose në raste tjera kur viktimat nuk ndjehet shumë i dëmtuar për të paraqitur rastin penal.

Rekomandojmë që të punohet më shumë me opinionin në këtë sferë me anë të programeve të ndryshme kombëtare, seminare, nëpërmjet medimeve që njerëzit të vetëdijsohen dhe t'a kuptojnë që çdo vepër penale është e dënueshme dhe nuk është turp që viktimat të paraqesë rastin kriminal dhe në këtë mënyrë të kontribuohet në luftën kundër kriminalitetit. Edhe institucionet përkatëse të veprojnë me shpejtësi dhe me dënime gjegjëse sipas kodit penal. Kjo arrihet vetëm duke depolitizuar dhe dekriminalizuar këto institucione.

Referenca:

1. Prof.Dr.Vlado Kambovski, E drejta ndëshkuese Botimi i katërt i plotësuar 2003;
2. Dr.Vesel Latifi, Kriminalistika 2004;
3. Dr.Ismail Zejneli, Disa Karakteristika të korrupsionit në Maqedoni dhe pengimi i tij ;
4. Dr.Ragip Halili, Kriminologjia botimi i gjashtë ;
5. Prof Dr.Luan Gjonça Korrupsioni Veprat penale përbërëse – Krimi i organizuar Tiranë 2004 ;
6. Dr.sci Xhemajl Ademaj, Metodika e hetimit të krimit Prishtinë 2006;

7. Xh. H. Retklif, Mendimi strategjik për zbulimin e kriminalitetit, Tabernakul, Shkup, 2009 ;
8. F. Rajkel, Doracak per Kriminalitet transnacional dhe Drejtësi, Datapons, Shkup, 2009.

Abidin TRENA

International University of Struga

a.trena@eust.edu.mk

Msc. Guximtar RUSHANI

International University of Struga

g.rushani@eust.edu.mk

DIVERSITETI KULTUROR SI PARIM I PROJEKTIT EUROPIAN DHE MULTILINGUALIZMI NË BE

ABSTRAKT

Me arritjen e strukturës së plotë në vitin 1993 me Marrëveshjen e Mاستrihtit, BE bëhet unike për nga lloji dhe diversiteti kulturor që arriti të përfshijë në vete në një kohë relativisht të shkurtër. Sot në Bashkimin Europian janë të anëtarësuar 28 shtete të cilat paraqesin kultura të ndryshme në vetvete. Multikulturalizmi paraqet një nga parimet themelore të Bashkimit Europian, e cila mund të shihet në qellimet e krijimit të BE-së, të paraqitura në Traktatin e Romës.

Bashkimi Europian në thelb është themeluar mbi idenë e multikulturalizmit, të bashkimit në diversitet ('United in Diversity'), e cila konsiston në ruajtjen dhe promovimin e diversitetit kulturor të shteteve përbërëse, si vlera të përbashkëta.¹

Këtu mund të shihet qartë se identiteti evropian paraqet një kornizë gjithpërfshirëse i cili i përfshin në vetvete minoritetet në diversitetin kulturor. BE si strukturë multinacionale dhe multikulturore në vete përfshin edhe një numër të madh gjuhësh të folura që e bënë atë një strukturë multilingualistike. Me zgjerimin e fundit të BE-së, numri i shteteve anëtare arriti në 28 dhe 24 gjuhë zyrtare të cilat ekzistojnë në një formacion të tillë supranacional të paprecedent.

¹ Founding treaty establishing European Community, Rome 1958;

Gjithsej, brenda kufijve të BE-së bëjnë pjesë rreth 200 dialekte duke i përfshirë këtu gjuhët rajonale, minoritetet dhe gjuhët e emigrantëve.²

Fjalë Kyçe: BE, Multikulturalizëm, diversitet kulturor.

HYRJE

Bashkimi European fillimisht ka qënë vetëm në formë të idesë ndër filozofët e kohës si p.sh Viktor Hygo si përfaqësues i ideve humaniste ka parashikuar një *“bashkim paqësor mes shteteve të Europës”*. Kjo ide u duk e pamundur me zhvillimin e historisë, gjate të dy luftave botërore. Mirëpo kjo ide filloi të rishfaqet mbi gjëmadhat e luftës së dytë botërore. Popujt që i kishin shpëtuar totalitarizmit, ishin të vendosur ti japin fund urrejtjes dhe rivalitetit në Europë. Ato vendosën të ndërtojnë paqe të përhershme mes armiqve të vjetër. Kështu në vitet 1945 - 1950 përfaqësues të lartë të shteteve të Europës perëndimore ndër të cilët Winston Churchill, Robert Schuman etj. kishin për qëllim t'i bindin popujt e tyre të hyjnë në një epokë të re. Do të krijohej një rend i ri në Europen perëndimore që do të bazohej në interesat e përbashkëta të popujve të tyre. Ky rend i ri do të bazohej në traktatet që do të garantonin zbatimin e ligjit dhe barazinë mes popujve.

Kjo strukturë arriti të marrë formën e saj më të plotë mbas shume vitesh edhe atë në vitin 1993 me Marrëveshjen e Mastrohtit. Kjo organizatë është unike për nga lloji dhe diversitetit kulturor që arriti të përfdhijë në vete në një kohë relativisht të shkurtër. Sot në Bashkimin European janë të anëtarësuar 28 shtete të cilat paraqesin kultura të ndryshme ne vetvete. Multikulturalizmi paraqet një nga parimet themelore të Bashkimit European, e cila mund të shihet në qëllimet e krijimit të BE-së, të paraqitura në Traktatin e Romës.

Bashkimi European në thelb është themeluar mbi idenë e multikulturalizmit, të bashkimit në diversitet (*‘United in Diversity’*), e cila konsiston në ruajtjen dhe promovimin e diversitetit kulturor të shteteve përbërëse, si vlera të përbashkëta.³

² Druviete, Ina, Multilingual European Union, 2009

³ Founding treaty establishing European Community, Rome 1958

‘United in diversity’’- (e përkthyer në shqip do të thotë ‘Të bashkuar në shumëllojshmëri’) paraqet moton kryesore të Bashkimit Europjan. Komisioni Europian e përshkruan kështu kuptimin e kësaj motoje:

“Motoja thotë se, nëpërmjet të BE-së, evropianët janë të bashkuar për të punuar së bashku për paqen dhe prosperitetin; dhe se ato shumë kultura, tradita dhe gjuhë të ndryshme në Evropë janë një pasuri pozitive për kontinentin.”

Kjo moto vjen si element kyç që nxit për një shoqëri të bashkuar dhe për identitet europian. Këtë aspekt e forcon edhe ‘*Liria e lëvizjes*’ e cila e ka lehtësuar në masë të madhe dialogun dhe shkëmbimin mes kulturave të ndryshme europjane. Shumica e qytetarëve europjanë shprehen si përkrahës së kësaj ideje. Sipas një sondazhi të EUROBAROMETER nëntë nga dhjetë europjanë mendojnë se kultura, shkëmbimet kulturore dhe dialogu ndërkulturore duhet të ketë vend të rëndësishëm në BE.

Qëllimin e shprehur në moto, i cili përkthehet si multikulturalizëm, e gjejmë të aplikuar në politikat e BE-së ndër të cilat në politikat e arsimit, hulumtimit, zhvillimit shoqëror dhe rajonal, emërtimin e rrugëve (e cila ndihmon në ndërtimin e vetëdijes kulturore), edukimin shoqëror, dhe nxitjen për aftësimin e gjuhëve të huaja tek qytetarët.

1. POLITIKA E BASHKIMIT EUROPIAN NË RAPORT ME DIVERSITETIN KULTUROR (MULTIKULTURALIZMI)

Çdo vit me miliona njerëz (turistë) nga SHBA-të dhe e gjithë bota vijnë drejtë kontinentit Europian për të vizituar këtë hapsirë me kulturë shumë të pasur. Duke nisur nga historia, muzika, arti visual dhe kultura të cilat bëjnë pjesë në jetën e përditshme të europjanëve. Në fakt, i gjithë suksesi dhe origjinaliteti i BE-së buron nga respekti për traditat, historinë, artin dhe gjuhët të cilat vijnë të ndërthurura mes 28 shteteve anëtare, gjë e cila gjithashtu paraqitet si garant për paqen, stabilitetin, prosperitetin në atë që dikur quhej rajoni i konflikteve. Kjo aftësi për respektin e ndërsjelltë kulturor ka ndihmuar në forcimin e rregullave të përbashkëta.

Në Bashkimin Europian kultura zë vend të veçantë. Bashkë me themelimin e njërës prej shtyllave kryesore të BE-së, që është, shkëmbimi i lirë i mallrave vjen edhe shkëmbimi i

aktiviteteve kulturore i cili luan rol shumë të rëndësishëm në bartjen e identitetit dhe vlerave mes shteteve europjane. Diversiteti kulturor është përforcuar edhe më shumë përmes lëvizjes së lirë të ideve, shkembimeve të vazhdueshme dhe bashkëveprimit mes europjanëve.

1.1 Politikat finaciare të BE-së për ndërtimin dhe zhvillimin e diversitetit kulturor

Kultura gëzon mbështetje politike dhe finaciare nga ana e BE-së por edhe nga ana e shteteve përkatëse. Sa i përket financimit BE-ja nga plani buxhetor 2007-2013 ka parashikuar investime prej 400,000,000 euro⁴ për të promovuar diversitetin kulturor dhe trashëgiminë kulturore të Europës.

Bashkimi European ndihmon në krijimin e një ambienti dinamik për industrinë kulturore, duke u mundësuar qasje më të lehtë në financim, pra duke i ndihmuar financiarisht, duke i ndihmuar me projekte kërkimore si dhe duke nxitur bashkëpunim me partnerët e brendshëm dhe të jashtëm të BE-së.

1.1.1 Programi MEDIA

Përmes programit MEDIA, BE-ja mbështet krijimin dhe shpërndarjen e mijëra filmeve, aktiviteteve trajnuese, festivaleve, promovimeve në shtetet anëtare dhe shtetet e tjera jo-europjane. Programi MEDIA në periudhën 2007-2013 ka siguruar 755,000,000 euro⁵ për ruajtjen dhe zhvillimin e diversitetit kulturor, për të rritur qarkullimin e veprave audiovizuale brenda dhe jashtë Unionit dhe forcimin e konkureshmërisë së sektorit audiovisual.

Disa nga këto vepra kinematografike kanë arritur të vlerësohen me cmime ndërkombëtare, sic kemi rastin me filmin ‘*Entre les murs*’ (i përkthyer Klasa) i cili është vlerësuar me çmimin Palma e Artë dhe filmi ‘*Gomorra*’ i cili u vlerësua me ‘Çmimin e Madh’ (Grand Prize) në festivalin e Kanës.⁶

⁴ <http://ec.europa.eu/culture>

⁵ po aty

⁶ http://ec.europa.eu/culture/media/index_en.htm

1.1.2 Programi ‘Kryeqytet i Kulturës Europiane’ (The European Capitals of Culture)

Turizmi dhe rigjenerimi urban përbëjnë gjithashtu pjesë kyce të agjendës kulturore të BE-së. Kështu, në dy dekadat e fundit nga ana e qyteteve europjane mund të shihet aftësia për të nxjerrë në pah pasurinë kulturore, diversitetin kulturor apo multikulturalizmin europian. Këto qytete promovojnë mirkuptim të ndërsjelltë dhe nxisin idenë e të qenit qytetarë europianë.

Në këtë aspekt një nxitje vjen edhe nga ana e BE-së, me anë të programit “*Kryeqytet i Kulturës Europiane*”. Ky paraqet një projekt ambicioz për zhvillim e multikulturalizmit dhe bashkëpunimit kulturor. I përkrahur nga fondet e BE-së, ky projekt shfaq trashëgiminë kulturore të qyteteve dhe rajonit afër tyre. Ky çmim u caktohet qyteteve për një periudhë prej një viti dhe gjatë kësaj kohe organizohen evente kulturore me performance të artistëve nga e gjithë Europa. BE-ja ndan nga 1,500,000 euro⁷ për qytetin përkatës si ndihmë për të financuar eventet kulturore dhe performancat e artistëve.

1.1.3 Programi ‘Etiketa e Kulturës Europiane’ (European Heritage Label)

Në tetor 2010, Komiteti Europjan i Kulturës dhe Arsimit votuan unanimisht miratimin e programit ‘*European Heritage Label*’ (Etiketa e Kulturës Europjane)⁸, i cili u jepet monumenteve natyrore, arkeologjike, urbane apo kulturore të cilat kanë luajtur rol në kulturën dhe historinë europjane apo integrimin europjan. Me këtë cmim vlerësohen gjithashtu pjesët e trashëgimisë të cilat simbolizojnë integrimin, idealet dhe historinë e BE-së. Komiteti Europjan i Kulturës dhe Arsimit e shpjegon krijimin e cmimit më rolin e cdo vendi anëtar në krijimin dhe zhvillimin e BE-së. Dhe me këtë vihet edhe një herë në pah multikulturalizmi në krijimin e Unionit.

2. BE-JO VETËM FUQI EKONOMIKE

Bashkimi European përveç se është një bllok ekonomik dhe një fuqi tregtare, ai paraqet një bllok social dhe kulturor të paprecedentë. Pasuria kulturore (diversiteti kulturor) është i lidhur ngushtë me rolin e saj në botë. Edhe pse dy të tretat e qytetarëve evropianëve mendojnë se ata

⁷ http://en.wikipedia.org/wiki/European_Capital_of_Culture

⁸ http://ec.europa.eu/culture/our-programmes-and-actions/doc2519_en.htm

ndajnë elementet e një kulture kolektive, në mbarë botën, diversiteti kulturor dhe dialogu ndërkulturor janë bërë sfida të mëdha. Një rend i ri global i bazuar në paqe, mirëkuptim të ndërsjellë dhe respektin për vlerat e përbashkëta kërkon njohjen e rolit të kulturës në marrëdhëniet ndërkombëtare. Mbështetje për mbrojtjen dhe promovimin e multikulturalizmit si një element i qeverisjes ndërkombëtare, është shumë e rëndësishme për BE-në.

Si palë në Konventën e UNESCO-s mbi Mbrojtjen dhe Promovimi i Diversiteteve dhe Shprehjes Kulturore, Bashkimit Evropian përfshin një dimension kulturor në marrëdhëniet e saj me vendet dhe rajonet jo anëtare të BE-së. BE-ja mbështet një shumëllojshmëri të gjerë të programeve kulturore, nga ana financiare dhe teknike në sajë të projektit për një botë në zhvillim. Këto projekte inkurajojnë ruajtjen dhe restaurimin monumenteve të trashëgimisë, të prodhimit dhe qarkullimit të veprave të artit, krijimi dhe restaurimin e muzeumeve, trajnimin e operatorëve dhe artistëve lokal të kulturës, si dhe organizimin e ngjarjeve të mëdha kulturore.

Në të njëjtën kohë, BE-ja fokusohet në mbështetjen e të drejtave të njeriut, duke përfshirë edhe mbrojtjen edhe promovimin e të drejtave kulturore, të drejtate popujve indigjene, si dhe të drejtat e pakicave dhe të shoqërive të marginalizuara. Bashkëpunimi kulturor gjatë shumë viteve ka qenë jo vetëm pjesë e ndihmës së dhënë për zhvillimin e rajoneve të botës, por ka ndihmuar edhe në bashkëpunimin e BE-së me partnerët kryesorë ndërkombëtarë.

Në tetor 2010, BE-ja dhe Kina themelojnë Forumin e nivelit të lartë kulturor për herë të parë në histori, me qëllim përforcimin e shkëmbimeve njeri-me-njeri dhe për të nxitur mirëkuptimin reciprok midis BE-së dhe Kinës. Nëpërmjet mbështetjes nga Anna Lindh Foundation, një rrjet i organizatave të shoqërive civile në Evropë dhe në të gjithë Mesdheun, Komisioni Evropian ndihmoi të sjellë njerëz nga 43 vende për të promovuar së bashku dialogun ndërkulturor dhe të përmirësojë mirëkuptimin reciprok.

Me anë të përpjekjeve Diplomacisë publike të BE-së, Delegacionet e BE-së shpesh bashkëpunojnë me Institucionet kulturore dhe misionet diplomatike të Shteteve Anëtare të BE-së për zhvillimin e programeve që përcjellin mesazhe të rëndësishme për vendet jo-anëtare të BE-së, rreth identitetit të saj, dhe përvojën e ndërtimit të urave lidhëse mes kulturave të ndryshme.

3. PROGRAMET KULTURORE TË BE-së JASHTË EUROPËS

Kids Euro Fest- Që nga viti 2008, çdo vjeshtë ambasadat e Shteteve Anëtare të BE-së dhe më shumë se 20 institucione të mëdha ndërkombëtare kulturore në Washington DC, kanë themeluar bashkërisht festivalin më të madh të femijëve në Shtetet e Bashkuara, duke shfaqur performanca nga artistët evropianë.⁹

Java e Evropës - Çdo Maj, Delegacionet e Bashkimi Evropian, të Shteteve të Bashkuara, Kombet e Bashkuara dhe misionet diplomatike të shteteve anëtare të BE-së në të gjithë SHBA-të bashkëpunojnë me universitetet, grupet e ekspertëve, organizatat joqeveritare dhe organizatat kulturore, për të krijuar një kuptim kulturor më të mirë mbi Bashkimin Evropian. Pikat e festimit një-javor të BE-së përfshijnë Open House¹⁰ në Washington DC, ku Ambasadat e BE mirëpresin publikun e gjerë, vizita shkollore nga BE dhe diplomatët e shteteve anëtare.

Showcase BE Film¹¹ -Për më shumë se dy dekada, Shtetet Anëtare të BE dhe Instituti Amerikan i Filmit në Silver Spring, Md, kanë prezantuar përvjetorin e Vitrinës së Filmit Europian, një përzgjedhje e filmave më të arrira nga shtetet anëtare të BE-së, duke përfshirë filma fitues të cmimeve ndërkombëtare, filma të radhitura në Box Office dhe premiera amerikane.

4. AGJENDA EUROPIANE PËR KULTURË (The European Agenda for Culture)

Agjenda Europiane për Kulturë u krijua në maj 2007, me tre qëllime kryesore për zhvillimin e kulturës dhe diversitetit kulturor edhe atë:

Në grupin a e parë to qëllimeve bëjnë pjesë: BE-ja dhe të gjithë anetarët e tjerë relevant duhet të punojnë së bashku për të nxitur dialogun ndërkulturor për të siguruar se diversiteti kulturor i BE-së është kuptuar, respektuar dhe promovuar. Për ta bërë këtë, ata duhet të kërkojnë , për shembull, rritjen e lëvizshmërisë ndërkufitare të artistëve dhe punëtorëve në sektorin kulturor dhe ndër-kufitar dhe perhapjen e veprave të artit.

⁹ http://www.kidseurofestival.org/index.php?option=com_content&view=article&id=23&Itemid=146

¹⁰ <http://www.eurunion.org/eu/event/10-europe-week.html>

¹¹ <http://www.afi.com/silver/new/nowplaying/EUshowcase>

Grupi i dytë i objektivave të fokusohet në: promovimin e kulturës si një katalizator në kuadrin e rritjes të vendeve të punës. Industritë kulturore janë një pasuri për ekonominë e Evropës dhe konkurrencën ekonomike. Kreativiteti kulturor gjeneron dy risi, atë social dhe teknologjik si dhe stimulon rritjen dhe vendet e punës në BE.

Promovimi i kulturës si një element jetik në marrëdhëniet ndërkombëtare të BE-së është vendosur në pjesën tretë e objektivave. Si palë në Konventën e UNESCO-s për mbrojtjen dhe promovimin e Diversitetit të Shprehjeve Kulturore, BE-ja është e angazhuar për të zhvilluar një rol të ri dhe më aktiv kulturor për Evropën në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe për integrimin e dimensionit kulturor si një element vital në marrëdhëniet e Evropës me vendet partnere dhe rajonin.

5. TOLERANCA SI VLERË PËR ZHVILLIMIN E MULTIKULTURALIZMIT DHE RUAJTJEN E PAQES

Toleranca është pjesa e cila garanton mbrojtjen e identitetit të dikujt dhe jetesën e përbashkët në një komunitet përmes respektimit të dinjitetit të të gjithë anëtarëve njësoj. Toleranca bashkë sikurse edhe liria dhe barazia paraqet parim themelor për demokracinë dhe liberalizmin të cilat i pretendon edhe BE-ja. Përmes tolerancës u bëhet thirrje popullit që të gjithë pjestarët e shoqërisë, madje edhe ata që i gjejmë të papëlqyeshëm t'u jepet mundësi të përfshihen në jetën sociale, politike, ekonomike etj.

6. MULTILINGUALIZMI NË BASHKIMIN EUROPIAN

Gjuha është pjesë e rëndësishme e kulturës së një populli, në këtë rast i popujve të Europës, kështu që projekti i integritit Europian do të jetë i suksesshëm vetëm në rast se ruhet dhe promovohet diversiteti kulturor. Arritjet e shumta kulturore të Evropës janë të lidhura ngushtë me arritjet e gjuhëve dhe traditave intelektuale të veçanta. Nëse këto gjuhë nuk ruhen edhe më tej, kjo do të thotë një humbje serioze dhe varfërim i diversitetit kulturor të Evropës. Shumica e gjuhëve europjane funksionojnë për komunikim të përditshëm të qytetarëve, si gjuhë amëtare, por gjuhë të tjera gjithashtu kanë ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e çdo qytetari.

Shumëgjuhësia (multilingualizmi) i referohet aftësisë së personit për të komunikuar në më shumë se një gjuhë (si multilingualizëm individual) dhe bashkë-ekzistenca e bashkësive të

ndryshme gjuhësore në një zonë gjeografike (si multilingualizëm shqëror). Multilingualizmi edhe në mënyrë zyrtare është shpallur si pjesë integrale e zhvillimit të Bashkimit Europjan në të tashmen dhe në të ardhmen. Megjithatë, proceset e integritit paraqesin çështje të ndërlikuara të cilat mund të ndikojnë edhe negativisht në çështjen e multilingualizmit (siç mund të jetë globalizmi). Kështu programi dhe mekanizmat për mbrojtjen e plotë të gjuhëve nën proceset e integritit europjan ka nevojë për përpunim të mëtejshëm.

Gjuha si mjet komunikimi, sidomos gjatë dy dekadave të fundit, paraqet tendencë për t'u futur në grupin e të drejtave themelore të njeriut, të ashtuquajtura të drejta natyrore. Me këtë edhe mbrojtja e të drejtës për të folur gjuhën amtare, garantohet me kushtetat e çdo vendi. Mirëpo, kur bëhet fjalë për një subjekt supra-nacional siç është BE-ja, plotësimi i plotë i të drejtave gjuhësore është më i vështirë. Në këtë drejtim BE-ja praktikat gjyqësore anti-diskriminuese gjuhësore i ka ende në zhvillim. Parimet themelore shpesh janë vënë në diskutim se si dokumentet e përgjithshme të BE duhet të përmirësohen në mënyrë që të reflektojnë diversitetin kulturor të shteteve anëtare dhe për të siguruar të drejtat gjuhësore të njeriut, për të gjithë qytetarët.

6.1 Faktorët që ndikojnë në zbehjen e multilingualizmit në BE

Prej mesit të shekullit XX, u zhvilluan dy tendenca kundërthënëse. Nga njëra anë filloi të përkrahet intensifikimi i globalizmit në të gjitha pjesët e jetës së njeriut, ndërsa nga ana tjetër ishte përkrahja e identiteteve të veçanta në jetën e njeriut. BE-së si projekt multi kulturor anon nga pjesa e globalizmit edhe pse paraqitet si ruajtës i identiteteve të veçanta kulturore. Këtë mund ta sqaroj kështu: BE-ja me përkrahjen e disa zhvillimeve me ose pa dashje ndikon në zbehjen e identiteteve gjuhësore rajonale. Në këto zhvillime bejnë pjesë korporatat ndërkombëtare, rrjedhja e lirë e mallrave, shërbimeve dhe të forcës punëtore, emigracioni, mas-media ndërkombëtare etj.

Një faktor tjetër i rëndësishëm për ruajtjen e identitetit gjuhësor është edhe mirqënia ekonomike. Identiteti i mirëqenies ekonomike nuk është përmendur shumë shpesh ndër identitetet tjera. Kjo ka një ndikim të drejtpërdrejtë në gjuhë. Njerëzit të cilët gëzojnë mirëqenie të mirë ekonomike janë të prirur ta ruajnë identitetin gjuhësor sepse nuk kanë nevojë ti nënshtrohen grupit identitar tjetër për për ta përmirësuar gjendjen ekonomike, ndërsa tek grupet me mirëqenie të dobët ekonomike ndodh e kundërta dhe mund të thyhet më lehtë identiteti gjuhësor.

6.2 Parimet e BE-së që mbrojnë multilingualizmin

BE-ja synon realizimin e një hapësirë të lëvizjes së lirë, lirisë dhe drejtësisë. Realizimin e kësaj Unioni tenton ta mundësojë me zhvillimin e demokracisë, solidaritetit, barazisë dhe antidiskriminimit, administratës efikase, ruajtjen dhe mbrojtjen e grupeve më të vogla të identiteteve kulturore dhe komuniteteve gjuhësore. Mirëpo në të gjitha këto rol të rëndësishëm luan komunikimi si pjesë e jetës së përditshme dhe i tillë komunikimi (gjuha- identiteti gjuhësor) duhet të mbrohet me rregulla zyrtare. Ekzistojnë disa parime të cilat janë propozuar për miratim nga Parlamenti Europjan që nga viti 2007, siç janë:

Gjithkush është i lirë në zgjedhjen e gjuhës për komunikim me të tjerët ", por në komunikimi me shërbimet publike dhe autoriteteve, të gjithë duhet të jenë në përputhje me dispozitat ligjore dhe gjuhësore që janë të aplikuara në vendin përkatës "

Në sferën private, secili ka të drejtë të komunikojë në gjuhën të cilën e zgjedh ai/ajo, por, ata që synojnë për të bërë punë të caktuar publike duhet të zotërojnë komunikimin në gjuhën lokale dhe të njohin dispozitat ligjore dhe gjuhësore të vendit të caktuar.

Në fushën e aktiviteteve private, të gjithë mund të organizojnë komunikimin në gjuhën të cilin ato preferojnë, por, në trajtimin me autoritetet publike, të gjithëve komunikimi duhet të jetë në përputhje me dispozitat ligjore dhe gjuhësore në fuqi në vendin në fjalë.

Në organizimin e brendshëm të biznesit të vet, çdokush është i lirë të përcaktojë gjuhën e komunikimit, por, për të aplikuar për një punë, të gjithë duhet të plotësojnë kërkesat e kualifikimit profesional duke përfshirë nevojën gjuhësore për komunikim të kërkuar për aktivitetin në fjalë nga firma punësimit, shoqata apo institucioni.

Komunikimi brenda shërbimeve publike dhe administratës në Shtetet Anëtare varet nga korniza ligjore dhe kushtetuese e vendit në fjalë.

Komunikimi i Institucioneve të Bashkimit European duhet të jetë jo-diskriminues, racional dhe efikas, prandaj, si udhëzues të përgjithshëm mund të thuhet komunikimi i jashtëm në drejtim të qytetarit dhe në kuadër të një mandati politik duhet të mbulojë të gjitha gjuhët zyrtare të Unionit.

KONKLuzion

Për sa kohë që diskriminimi në komunikimin e brendshëm të institucioneve të Bashkimit ekziston, organet kompetente në nivel të Unionit dhe autoritetet arsimore në Shtetet Anëtare duhet të ndërmarrin kërkime në fushën e një sistemi jo-diskriminues si model universal për gjuhën , kushtet e saj, kapacitetet dhe kufijtë, për të mbështetur studimet e fizibilitetit dhe për të lehtësuar eksperimentet gjuhësore dhe në fund të fundit për zgjidhjen e diskriminimit mbetur në marrëdhëniet e brendshme ndëretnike.

Së fundi, është në përgjegjësinë e autoriteteve kompetente të shteteve anëtare dhe të organeve kompetente në nivel evropian për të bashkërenduar praktikat më të mira në këtë fushë, të organizojnë mësimin gjuhës në shkollat e nevojshme, për të ofruar dhe garantuar diversitet në mësimin e gjuhës, dhe, më në fund, për të mbrojtur identitetet kulturore dhe gjuhësore brenda këtij Bashkimi shumëgjuhësor.

Referenca:

Libra, Publikime

- Bello, Marko, E drejta institucionale komunitare Evropiane, Tirane, 2010;
- Druviete, Ina, Multilingual European Union, 2009;
- Fonten, Paskal, Evropa në 12 leksione, Bruksel, 2003;
- Reka, Blerim; Sela, Ylber, Hyrje në drejtën e Bashkimit Evropian, Tetova, 2011;

Burime nga interneti

- <http://bama.ua.edu/~sborrell/psc521/tolerance.pdf>;
- <http://www.eurunion.org/eu/images/stories/euinsight-cultpol-dec2010.pdf>;
- <http://ec.europa.eu/culture>;
- <http://www.eurunion.org/eu/EU-Insight.html>;
- http://en.wikipedia.org/wiki/European_Capital_of_Culture;
- http://ec.europa.eu/culture/our-programmes-and-actions/doc2519_en.html;
- <http://www.afi.com/silver/new/nowplaying/EUshowcase/>;
- <http://www.eurunion.org/eu/event/10-europe-week.html>;

- [http://www.kidseurofestival.org/index.php?option=com_content&view=article&id=23&Itemid=146;](http://www.kidseurofestival.org/index.php?option=com_content&view=article&id=23&Itemid=146)
- [http://ec.europa.eu/culture/media/index_en.html;](http://ec.europa.eu/culture/media/index_en.html)
- [http://www.europe-citizen.net/documents_symposium/declaration.html.](http://www.europe-citizen.net/documents_symposium/declaration.html)

Msc.Nurten Kala DAUTI

PHD Candidate

International University of Struga- Teaching assistant

n.kala@eust.edu.mk

PAGESA E PUNËS DHE KOMPENSIMET

ABSTRAKT

Paga për punë është elementi kryesor në të drejtën e punës dhe motivi kryesor i punëtorit për të punuar. Shpërblimi i punëtorëve për mundin që kanë dhënë, domethënë për punën e bërë si term në teori dhe legjislacion që përdoret është paga. Ajo është mbajtëse e jetës ekonomike dhe sociale të çdo shoqërie. Prandaj, është krejtësisht e kuptueshme që pagave dhe politikës së shpërblimit në përgjithësi, çdo herë i është kushtuar dhe i kushtohet vëmendje e madhe nga ana e punëdhënësve, puntorëve dhe nga vet qeveria. Në botën bashkëkohore nuk ekziston një sistem unik për pagesën e punëtorëve.

Qëllimi është që rreth çështjes së pagave të ketë sa më pak problem. Paga nuk mund të jetë më e ulët se paga minimale e përcaktuar në të drejtën positive në Maqedoni.

Fjalë kyçe: *Pagesa, punëdhënës, punëtor, kompenzim i rrogës, dita e pages.*

HYRJE

Punëdhënësi dhe puntori lidhin kontratë për punësim në të cilën i parashohin të drejtat dhe detyrimet. Një ndër të drejtat e puntorit është që për punën e kryer të merr shpërblim apo ti bëhet pagesa nga punëdhënësi. Pagesa bëhet gjithmonë në para.

Rroga e punëtorit bëhet vbarësisht prej kërkesës së vendit të punës, cilësisë së punës dhe statusit të punëtorit në punë. Nëse punëtorit tregon suksese të mëdha punëdhënësi përveç pagës edhe e shpërblen.

Në qoftë se punëtori nuk mund të jetë në vendin e punës për shkak të vis major, sëmundjes apo për arsye të problemeve në vendin e punës nga ana e punëdhënësit punëtorit pagesa i bëhet e plotë. Pra, me fjalë të tjera punëdhënësi obligohet që punëtorit t'i paguajë kompensimin e rrogës për ditët dhe orët, aq sa është obligimi i punës së punëtorit për ditët kur për shkaqe të arsyeshme nuk punon.

Vendi dhe data e pagesës do të bëhet sipas marrëveshjes dhe duke respektuar ligjet në fuqi.

1.LLOGARITJA E LARTËSISË SË PAGËS

Paga e punëtorit përfshin pagën bazë të përcaktuar në kontratën e punës, si dhe çdo shtesë mbi pagën që është me karakter të përhershëm, Paga është një nga elementët që duhet të përcaktohet në kontratë, por në rast se nuk është caktuar, punëdhënësi detyrohet të paguajë punëmarrësin me pagën e zakonshme për atë lloj pune.¹

Si kategori juridike, paga është shpërblimi në të holla që ndërmarrja, institucioni detyrohet që ti jap çdo punëmarrësi, kundrejt punës efektivisht të kryer dhe në përshtatje me parimet dhe kriteret e caktuara në dispozitat përkatëse të Kushtetutës e të legjislacionit të punës.²

Punëtori ka të drejtë që për punën e kryer të marrë rrogë, duke u respektuar ligji i mardhënies së punës, marrëveshjes kolektive dhe marrëveshjes për përpunësim. Pagesa e punëtorit gjithmonë duhet të jetë në para. Punëdhënësi është i obliguar punëtorit t'ia paguajë pagesën çdo muaj, personalisht ose në transferrin bankar dhe të shoqëruar me dëftesën e pagesës.

Dëftesa e pagesës duhet të përmbajë këto të dhëna: emrin dhe selinë e punëdhënësit, numrin e regjistrimit në regjistrin e subjekteve afariste, emrin dhe mbiemrin e punëtorit, muajin dhe vitin

¹ Starova, Gëzime.” E drejta e Punës”, Shkup, fq.282

² Çela, Kudrejt.” E drejta e punës”, Tiranë, 2015, fq . 373

për të cilin bëhet pagesa, numri i orëve për të cilat bëhet pagesa, periudha e pushimit gjatë asaj kohe, paga për një orë pune dhe për punën mujore.³

Pagat ndërtohen ashtu që janë vetëm një shpenzim I posaçëm I prodhimit dhe burim kryesor I të ardhurave të puntorit, por që ndikon në rritje të rendimentit të punës dhe përmirësim të prodhimit.

Paga përbëhet nga rroga bazë, pjesa e rrogës për suksesin në punë dhe shtesat.

Në nenin 106 thuhet të LMP në Maqedoni thuhet:

1. Rroga bazë përcaktohet duke i marrë parasysh kërkesat e vendit të punës, për të cilat punëtori e ka lidhur marrëveshjen për punë;
2. Suksesi në punë i punëtorit përcaktohet duke marrë parasysh sjelljen me nikoqirlëk, kualitetin dhe kuantitetin e punës së kryer, për të cilën punëtori e ka lidhur marrëveshjen për punësim.

Shtesat përcaktohen për kushtet e veçanta të punës, që dalin nga orari i punës dhe për punën me ndërrime, punë me orar të ndarë të punës, punë nate, punë të vazhduar, punë në ditën e diel, punë në ditë feste të përcaktuara me ligj dhe shtesa për stazhin e punës⁴

Rroga e punëtorit për punë me orar të plotë të punës nuk mund të jetë më e vogël se rregra e pëcaktuar me ligj dhe me marrveshje kolektive.

Në Republikën e Maqedonisë rroga minimale e pëcaktuar është 8.000 denarë.

Gjatë përcaktimit të pagës minimale duhet të merren parasysh këto faktorë:

- kostoja e shpenzimeve jetësore;
- përqindja e shkallës së papunësisë;
- gjendja e përgjithshme në tregun e punës
- shkalla e konkurrencës dhe produktivitetit në vend.⁵

³ Bujupi-Ismajli, Hava. "E drejta e punës" prishtinë, 2007, fq191-192

⁴ Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë "ligji për marrdhëniet e Punës" nr.62/2005

⁵ <http://www.slideshare.net/bande7/e-drejta-e-punes>

Paga minimale në përputhje me ligjin përcaktohet në bazë të faktorëve ekonomik, kërkesave të zhvillimit ekonomik, zvoglimit të papunësisë, rritjen e prodhimit, nevojave të puntorit dhe familjeve të tyre, të ardhurat e përfituara nga sigurimet shoqërore dhe nivelet e jetës së grupeve të ndryshme shoqërore.⁶

Nuk konsiderohen si pjesë përbërëse të pagës shpërblimet që merr punëmarrësi për shpenzimet e kryera për shkak të veprimtarisë së tij profesionale.

LMP po ashtu ka përcaktuar paga të njëjta për meshkuj dhe femrat në nenin 106, në parag.1 thuhet punëdhënsi obligohet që për punën e njëjtë me kërkesat e njëjta në vendin e punës t'u paguajë rrogë të njëjtë punëtorve pa dallim gjinie., ndërsa në parag.2 thuhet : dispozitat e marrëveshjes për punësim, marrëveshjes kolektive përkatësisht aktit të përgjithshëm të punëdhënsit që janë në kundërshtim me paragrafin (1) këtij neni të janë të pavlefshme.

Pra, është ndaluar diskriminimi midis puntorëve në vendin e punës nga ana e punëdhënësit, duke përcaktuar në ligj që për punën e njëjtë të paguhet njëjtë punëtorët pa dallim gjinie dhe nëse nuk respektohen nga ana e punëdhënësit atëherë kontrata e punës është e pavlefshme.

2.VENDI DHE DITA E PAGËS

Në kontratën punës është përcaktuar vendi dhe dita kur punëdhënsi do ta paguaj puntorin për punën e kryer.Pagesa e punëtorit bëhet nëpërmjet zhirollogarisë bankare, për periudhë kohore që nuk mund të jetë më e gjatë se një muaj.

Në nenin 108 të LMP është përcaktuar për vendin e pagesës si në vijim:

- (1) Punëdhënsi obligohet që puntorit t'ia paguajë rrogën deri në fund të ditës së pagesës në vendin e zakonshëm të pagesës.
- (2) Nëse rroga paguhet përmes bankës në llogarinë e punëtorit ose në mënyrë tjetër jo me para të gatshme, rroga doemos duhet t'i jepet në dispozicion punëtorit në ditën e caktuar të pagesës, përveç nëse palët nuk janë marrë vesh ndryshe.

⁶ Çela, Kudrejt.” E drejta e punës”, Tiranë, 2015, fq . 375

- (3) Punëdhënsi obligohet që punëtorit gjat çdo pagese të rrogës si dhe më 31 janar të vitit të ri kalendarik t'i lishojë llogarinë me shkrim të rrogës, kontributeve të rrogës dhe kompensimeve të rrogës për periudhën e pagesës përkatësisht për vitin e kaluar, prej të cilave shihen gjithashtu edhe llogaritja dhe pagesa e tatimeve dhe kontributeve .
- (4) Shpenzimet lidhur me pagesën e rrogës janë në llogari të punëdhënsit.⁷

Punëdhënësi pagesën duhet ta bëjë më së voni deri në 15 ditë pas caktimit të periudhës së pagesës. Mirëpo, nëse dita e pagesës është ditë e lire apo ditë feste, atëherë pagesa do të bëhet ditën e pare të ardhme të punës.

Punëdhënsi obligohet që paraprakisht me shkrim t'i njoftoj punëtorët për ditën e pagesës dhe për çdo ndryshim të ditës së pagesës.

3.KOMPENSIMI I RROGËS DHE SHPENZIMEVE LIDHUR ME PUNËN

Në parim, punëtori gëzon të drejtën e pagës për punën dhe paga i sigurohet përpjesëtimisht me punën e kryer dhe me kontributin që e ka në krimin e fitimit të përgjithshëm të punëdhënsit. Përpos pagës për kohën kur punon punëtori i takon kompensimi i pagës për kohën kur nuk punon. Kushtet e kompensimit të pagës që i takon punëtorit, kohëzgjatja e pagës së kompensimeve si dhe lartësia e tyre përcaktohet me ligj dhe me marrëveshje kolektive.

Disa nga kompensimet e pagës i përballon punëdhënsi, p.sh kur punëtori mungon nga puna për shkak të aftësimin dhe përsosjes profesionale, ndërsa disa organi i cili ka qenë shkak që punëtori ka munguar në punë. I tillë është rasti p.sh. me pjesëmarrjen në stërvitje ushtarake ose paraqitja në përgjigje të thirrjeve të organeve të tjera pa fajin e punëtorit.

LPM e rregullon posaçërisht të drejtën e kompensimit të pagës së punëtorit gjatë ndërprerjes së punës nga shfaqja e kushteve të posaçme, si p.sh në rastet kur mungojnë energjia, lëndet e para, materialet e ri prodhimit ose kur duhet të mënjanoen defektet. Për ndërprejten e këtillë të punës punëtori nuk duhet të ketë faj, sepse në rastin e kundërt jo vetëm që nuk ka vend për kompensimin e pagës, por parashtrohet edhe çështja e përgjegjësisë së tij, veçanërisht nëse gjatë ndërprejes është

⁷ Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” ligji për marrdhëniet e Punës” nr.62/2005

shkaktuar dëm. Në këtë rast të ndërprejes puntori ka të drejtë kompensimit të pagës në një periudhë jo më të gjatë se 30 ditë, nëse nuk është e mundur që me punë në ditët e lira ose në ditët e pushimit javor të kompensohet kohëzgjatja e plotë e punës që është humbur (neni 80).⁸

Për kompensimet e pagës në nenin 112 të LMP është caktuar që:

- (1) Punëtori ka të drejtë për kompensim të rrogës për tërë kohën e mungesës në rastet dhe kohëzgjatje të përcaktuara me ligj, si dhe në rastet kur nuk punon për shkak të punëdhënsit.
- (2) Punëdhënsi obligohet të paguaj kompensim të rrogës në rastet e mungesës nga puna përshkak të shfrytëzimit të pushimit vjetor, pushimit të dhunshëm të paguar, arsimit plotësues, festave të përcaktuara me ligj dhe ditëve të lira të punës dhe në rastet kur punëtori nuk punon për shkak të punëdhënsit.
- (3) Punëdhënsi paguan kompensim të rrogës edhe në rastet e paafetësisë së punëtorit për punë për shkak të sëmundjes ose lëndimeve deri në 21 ditë, ndërsa mbi 21 ditë paguhet në llogari të sigurimit shëndetësor. Në rastet e hapjes së pushimit mjekësor në afat prej tri ditësh nga ndërpreja e pushimit paraprak mjekësor, punëdhënsi ka të drejtë të kërkojë nga komisioni mjekësor i shkallës së parë, ta konfirmojnë pushimin e ri mjekësor ose ta vazhdojnë pushimin e vjetër mjekësor të shkurtuar.
- (4) Punëdhënsi mund të paguajë nga llogaria e obliguesit tjetër kompensimin për rrogë gjithashtu dhe në rast se kështu është përcaktuar me ligj ose rregull tjetër.
- (5) Nëse punëtori nuk mundë ta kryej punën për shkak të fuqisë madhore, ka të drejtë në gjysmën e rrogës, për të cilën do të kishte të drejtë nëse do të punonte.
- (6) Nëse me këtë ligj ose me ligj tjetër nuk është përcaktuar ndryshe, punëtorit i takon kompensimi i rrogës në lartësinë e rrogës së tij mesatare nga dymbëdhjetë muajtë e fundit. Nëse punëtori në këtë periudhë nuk ka marrë rrogë, i takon kompensim në lartësinë e rrogës më të vogël.
- (7) Punëdhënsi obligohet që punëtorit t'i paguajë kompensimin e rrogës për ditët dhe orët, aq sa është obligimi i punës së punëtorit për ditët kur për shkak të arsyeshme nuk punon.
- (8) Në rastet të ndërprejes së procesit punës për shkak të afariste, punëdhënsi obligohet që punëtorit t'i lishojë aktvendim dhe t'i paguajë 70% të rrogës për periudhën deri në tre muaj në vitin vijues.

Punëtori ka të drejtë kompensim për shpenzimet lidhur me punëtorin për: ushqim gjat kohës së punës, nëse paguhet me shumë në para; transport nga dhe deri në punë, udhëtim zyrtar; shtesë

⁸ Starova, Gëzime. "E drejta e Punës", Shkup, fq.285

terreni; shfrytëzimin e veturës private për udhëtime zyrtare; jetën e ndar nga familja, dhe vdekjen e punëtorit ose anëtarit të familjes së tij.

Punëtori ka të drejtë pagese për shkuarje në pesnion si dhe për shpërblime jubilarë.

Lartësia, baza dhe afati për lligaritjen dhe pagesën e kompensimit të këtyre shpenzimeve përcaktohet me marrëveshjen kolektive.

Poashtu punëtori ka të drejtë të shtesës për vjetërsi në punë, që u jepet për çdo vit në punë. Kjo e drejtë realizohet deri në 15 vjet përvoj pune, të cilën e përfitojnë automatikisht të gjithë puntorët.

KONKLuzion

Rregullimi juridik i pagave të punës, është një ndër çështjet më të rëndësishme, nëpërmjet të së cilës bëhet zgjidhja e problemeve sociale, ekonomike, juridike dhe politike të shteteve demokratike. Punëtori për punën e kryer te punëdhënësi merr shpërblim, duke repsektuar marrëveshjen individuale që është hartuar në bazë të ligjit të mardhënies së punës dhe kontratës kolektive. Të drejtat e puntorit janë garantuar në një formë duke përcaktuar pagën minimale, kështu që punëdhënësi nuk mund ta paguaj më pak se paga minimale, një veprim i tillë do konsiderohej si shkelje e ligjit dhe kontrata do vlersohet si e pavlerë.

Në pajtim me përmbajtjen dhe me frymën demokratike të konventave ndërkombëtare, në pajtim me dispozitat Kushtetuese dhe ligjin për mardhënie pune ndalohen të gjitha format e diskriminimit në bazë të racës, gjinisë, fesë, kombësisë, etj. Do me thënë, punëdhënësi jep paga të njëjta si për femrat dhe për meshkujt që kryen punën e njëjtë. Pagesa duhet ti bëhet në vendin dhe në datën e caktuar në marrëveshje. Mund të bëhen ndryshime nëse punëdhënësi dhe puntori merren vesh ndryshe nga ajo që e kanë parapara në kontratë për pagesën, por gjithmonë duke dokumentuar me shkrim.

Puntori paguhet edhe për pushimin ditor, javor, vjetor, ditët e festave, rekomandimeve të mjekut, nëse ndërpritet puna për shkaqe afariste apo për arsye të punëdhënësit.

Normat juridike të së drejtës së punës për pagesën e puntorit kanë një qëllim, që të nxisin në ndërgjegjen e njerëzve efikasitetin në punë, të rrisin prodhimin, cilësinë, minimizimin e humbjeve në punë, rritjen e mirëqenies së njeriut dhe ekonominë e shoqërisë nëpërgjithësi.

Referenca:

1. Starova, Gëzime," E drejta e Punës", Shkup,2006;
2. Bujupi-Ismajli, Hava," E drejta e punës" Prishtinë, 2007;
3. Çela, Kudrejt,"E drejta e Punës", Tiranë, 2016;
4. Doko-Lumani, Fatmire," E drejta e Punës",Tetovë,2013;
5. Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Ligji për Marrdhëniet e Punës" nr.62/2005;
6. <http://www.slideshare.net/bande7/e-drejta-e-punes>.

Msc.Senada LAÇKA

International University of Struga

s.lacka@eust.edu.mk

AKTORËT KRYESORË NË KONFLIKTIN IZRAEL- PALESTINË

ABSTRAKT

Në vitin 1948, Kombet e Bashkuara deklaruan se territori britanik i njohur si Palestina do të ndahet në dy shtete të pavarura: Izrael dhe Palestinë. Liderët arab e kundërshtuan këtë deklaratë dhe nisën pushtimin për të mbajtur një Palestinë arabe të pavarur. Ata e humbën luftën dhe në fund të luftimeve, Izraeli kontrollonte më shumë territor se sa ishte e përfshirë në deklaratën e OBK-së, që garantonte shtetin e ri izraelit.

Një nga vendet palestineze që ende kontrollohet nga Izraeli është Rripi i Gazës. Izraeli e pushtoi këtë territor në vitin 1967, pas dështimit të një përpjekje tjetër të shteteve arabe për pushtim. Trupat e Izraelit u tërhoqën nga Gaza pas një marrëveshje në vitin 2005. Por Izraeli ende e kontrollon këtë vend me rregulla strikte për tregtinë brenda dhe jashtë, ku papunësia arrin në 40%. Rreth 38% e palestinezëve jetojnë nën minimumin jetik.

Fjalë Kyçe: *Izrael, Palestinë, OKB, Gaza.*

HYRJE

Shumica e ekspertëve të Lindjes së Mesme besojnë se Izraeli dhe palestinezët do të arrijnë një marrëveshje, por vetëm atëherë kur të moderuarit në të dy krahët do të kenë një avantazh të qartë kundër ekstremistëve.

Izraeli dëshiron që palestinezët të pranojnë sinqerisht ekzistencën e tij, ndërkohë që palestinezët kërkojnë krijimin e shtetit me kryeqytet në Jerusalem, si dhe të drejtën e refugjatëve palestinezë të shpërngulur prej luftës së vitit 1948 – që të rikthehen në Izrael.

Deri atëherë, është e rëndësishme që të mbahet ndezur flaka e negociatave, si dhe që të moderuarit nga të dy anët të ruajnë lidhjet dhe të mos bien në dëshpërim. Sidoqoftë, do të duhen vite përpara se të dy palët të jenë në një pozicion për të mbërritur në një zgjidhje përfundimtare.

1.FORCAT MBROJTËSE TË IZRAELIT

Izraeli ka ushtrinë më të fuqishme në Lindjen e Mesme, e ndjekur nga Turqia dhe Arabia Saudite. Kështu thuhet në një raport të ri të *“Business Insider”*. Forcat mbrojtëse izraelite kanë më shumë cilësi se ushtritë e tjerë të vendeve të rajonit. Mjafton këtu të kujtojmë forcat ajrore që ka ky shtet. Kjo renditje e hartuar nga ekspertë bazohet në rritjen e aftësive operacionale ushtarake në të gjithë rajonin, por edhe tek artileria dhe teknologjia. Raporti i hartuar nga dy ekspertë: Patrik Megahan dhe Kris Harmer, ekspert i mjeteve luftarake detare në SHBA.

Arsyet sepse Izraeli qëndron në majë të listës janë disa por më shumë rëndësi i jepet suksesit në luftën kundër Sirisë dhe Izraelit në vitin 1967 dhe 1973, si edhe ajo kundër grupeve palestineze.

Në raport nënvizohet gjithashtu se fakti që Izraeli ka një avantazh të dukshëm në rajon, vjen në sajë të marrëdhënieve të ngushta me SHBA-në dhe investimeve në industrinë e saj mbrojtëse ku përfshihen asetet hapësinore, avionë shumë të avancuar luftarakë, drone dhe armë bërthamore.

Ndryshe nga ushtritë e tjerë të rajonit, Izraeli mund t'i mobilizojë forcat ushtarake në një kohë mjaftë të shpejtë, që jo vetëm në rajon por edhe në botë përbën rekord. Ndryshe nga ushtritë e tjera, si në Turqi, Siri dhe së fundi në Egjipt, ushtria izraelite nuk ka tentuar asnjëherë për grusht shteti brenda vendit. Megjithatë Turqia dhe Arabia Saudite kanë ushtritë dhe buxhetet më të mëdha në Lindjen e Mesme ato sërish renditen në vendin e dytë dhe të tretë.

Turqia, me 18 miliardë dollarë në dispozicion të mbrojtjes, arriti të modernizojë pak ushtrinë e saj. Është për t'u vlerësuar se një pjesë e teknologjisë së saj është përpunuar dhe prodhuar brenda vendit.

Akoma më e frikshme sa i përket buxhetit dhe fuqisë financiare të investuar për mbrojtjen është Arabia Saudite. Buxheti i saj është 56 miliardë dollarë, duke e renditur atë si shpenzuesin e katërt në botë për ushtrinë pas SHBA-së, Kinës dhe Rusisë.

Sipas “*Business Insider*” sa i përket arsenalit të armëve Arabia është e dyta pas Izraelit, por kjo mund të ndryshojë. Forcat ajrore saudite së shpejti mund të jenë më të përparura se ato izraelite. Pas Arabisë Saudite vijnë Emiratet e Bashkuara Arabe dhe Irani.

Forcat Mbrojtëse të Izraelit:

- Forcat Ajrore të Izraelit
- Marina e Izraelit
- Komanda e Ushtrisë
- Shayetet 13-¹

2. FUQIA USHTARAKE E HAMASIT

Hamasi është një shkurtime i lëvizjes islamike për rezistencë dhe që në arabisht do të thotë “përkushtim”. Hamasi është angazhuar zyrtarisht për të shkatërruar Izraelin dhe për të krijuar një shtet islamik në vend të tij. Por Hamasi ka deklaruar se do të pranonte krijimin e një shteti palestinez në tokat e pushtuara nga forcat izraelite në luftën e vitit 1967 në këmbim të një armëpushimi afatgjatë. Hamasi ka kundërshtuar kërkesat nga Izraeli, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe vendeve të tjera për të njohur shtetin Hebre dhe për të çarmatosur Izraelin dhe Shtetet e Bashkuara janë përpjekur të izolojnë Hamasin.

Forca kryesore e sigurisë të Hamasit është rritur në madhësi që kur ky i fundit morri kontrollin e Rripit të Gazës në qershor të vitit 2007. Në zemër të forcës kryesisht ka anëtarë të krahut të armatosur të Hamasit, Brigada Izz-el-Deen Al-Qassam, por ajo përfshin disa anëtarë të fraksioneve militante, të tilla si Komitetet e Rezistencës Popullore. Mendohet se kjo brigadë ka

¹ Shayetet 13” mban moton zyrtarë të ushtrisë së Izraelit, “Kurrë më” dhe i referohet Holokaustit. Ndërsa motoja jozyrtare, duke qenë se trupave speciale të “Shayetet 13” u pëlqen të bëjnë shaka është “Kur puna bëhet keq hebrejtë ia mbathin vrapit”. Ata janë një prej tre forcave elitare speciale të Izraelit. “Shayetet 13” janë të specializuar në shpëtimin e pengjeve dhe kundër terrorizëm, e mbi të gjitha ata janë të stërvitur për të vrarë armikun.

rreth 25.000 anëtarë, por nuk është e qartë se sa prej tyre janë të përfshirë në njësi të tjera. Duke marrë parasysh faktin se Gaza është e rrethuar, Hamasi i drejtohet përkrahësve të tij në Bregun Perëndimor, por pjesa më e madhe e tyre janë të rrethuar nga forcat izraelite dhe nga forcat e sigurisë palestineze, besnike ndaj presidentit Mahmoud Abbas.

Hamasi fitoi zgjedhjet parlamentare të vitit 2006 me ndihmën e premtimeve të tij për të çrrënjësuar korrupsionin në Autoritetin Palestinez dhe për të luftuar kundër Izraelit. Ai është gjithashtu popullor për shkak të një rrjeti bamirësie që drejton.

Por Hamasi nuk është thjeshtë një organizatë terroriste. Hamasi është një ide. Një ide e dëshpëruar dhe fanatike, që u zhvillua nga mërzia dhe zhgënjimi i shumë palestinezëve. Asnjë ide nuk ka fituar deri tashmë përmes forcës - as nga shtrëngesat, as nga bombardimet, as nga shtypja e zinxhirëve të tankeve, as nga komandot marine. E vetmja mënyrë që Izraeli të nxjerrë jashtë loje Hamasin, është mbërritja e shpejtë e një marrëveshjeje me palestinezët për ngritjen e një shteti të pavarur në Bregun Perëndimor dhe Rripin e Gazës në kufijtë e vitit 1967, me kryeqytetin e tij në Lindje të Jeruzalemit. Izraeli duhet të nënshkruajë një marrëveshje paqeje me Mahmoud Abbas dhe qeverinë e tij, dhe kjo e kthen konfliktin Izrael-Palestinë në një konflikt mes Izraelit dhe Rripit të Gazës. Ky konflikt i zgjatur mund të zgjidhet, në fund, vetëm përmes negociatash me Hamasin, në mënyrë të arsyeshme, me integrimin e lëvizjes Fatah të Abbasit me Hamasin. Edhe sikur Izraeli të nisë edhe njëqind anije më shumë drejt Gazës, edhe sikur të dërgojë atje njëqind herë më shumë trupa për të pushtuar Rripin e Gazës, pavarësisht se sa herë të tjera Izraeli do të aktivizojë ushtrinë e tij, policinë dhe forcat sekrete, nuk do të mund ta zgjidhë problemin.. Derisa izraelitë e palestinezë, do t'i njohim konsequencat logjike të këtij fakti të thjeshtë, ato të gjithë do të jetojnë një gjendje të vazhdueshme izolimi - Gaza nën shtrëngesën izraeliet, Izraeli nën shtrëngesën ndërkombëtare e arabe.

3.ORGANIZATA PËR ÇLIRIMIN E PALESTINËS (OLP)

Lindi në Jerusalemin Lindor në vitin 1964, atëhere nën pushtimin jordanëz. Qëllimi i OLP-së, një bashkësi fraksionesh politike dhe ushtarake palestineze, ishte shkatërrimi i Izraelit dhe krijimi i një Palestine arabe. Karta e OLP-së që formoi të gjitha bazat ideologjike të të gjithë fraksioneve palestineze deri në Marrëveshjen e Oslos në v.1993 përcaktonte një lëvizje raciste dhe fanatike në formacionin e saj, me synime ekspansioniste. Nga kjo pikpamje, OLP ishte një

koalicion grupesh të armatosur mes të cilëve më i rëndësishmi ishte grupi “Al Fatah “ i Jaser Arafatit². Grupe të tjera të përfshira ishin FPLP i George Habbas, FDPLP i Nayef Hawatmeth dhe FLP e Abu Abbas-it. Të gjitha grupet pjesëmarrëse të OLP-së e konsideronin luftën e armatosur mjet nëpërmjet të cilit mund të arrinin objektivin e tyre për të çliruar Palestinën. Pavarësisht se kishin një retorikë të përbashkët, kishte shume problematika në raportet midis vendeve arabe dhe OLP-së gjatë Shtatorit të ZI, në vitin 1970 kur mbreti Hussein dekretoi një repression të ashpër kundër palestinezëve. Procesi i paqes me Izraelin që filloi në vitet 90’, pas shpërthimit të kryengritjes së parë në vitin 1987, shtyu Jaser Arafatin të hiqte dorë nga synimet për shkatërrimin e Izraelit.

4.ROLI I SHBA-së NË KRIZËN E PALESTINËS DHE IZRAELIT

Konflikti arabo-izraelit ka qënë, është dhe do të jetë problem më i mprehtë dhe më i rëndësishëm për t’u zgjidhur dhe kërcënimi më i madh në Lindjen e Mesme e më tej. SHBA qëndron me vendosmëri dhe pa kompromis në anën e Izraelit dhe kjo ka një ndikim shumë negativ në rolin që SHBA mund të luajë në këtë rajon. “Popullsia çifute në SHBA është afër 4 % e të përgjithshmes, por ajo ka bërë shumë për ta radhitur SHBA pas Izraelit. Ka disa arsye për forcën e lobit çifut në SHBA. Veçanërisht domethënës është ndikimi politik që ka bashkësia e pasur çifute. Kjo është me rëndësi sepse politika amerikane financohet dhe kontrollohet gjërësisht nga interesat private.”³ Izraeli po e keqpërdor konceptin e “luftës kundër terrorizmit” për të çuar përpara terrorizmin e tij shtetëror që të shpërthejë luftra të reja agresive në rajon dhe që të ndërmarrë fushata të reja spastrim etnik në dëm të popullit palestinez.

Sipas revistës turke BD të muajit mars 2003 rezervat botërore të njohura të naftës janë si vijon: SHBA, 3.7 miliard ton, Amerika e Veriut 8.4 miliard ton, Europa 2.5 miliard ton, Azia dhe Pacifiku 5.9 miliard ton, Afrika 10. 2 miliard ton, Amerika Latine 13.7 miliard ton, kurse rreth Gjirit Persik ndodhen 91.7 miliard ton (Iran 3.7 miliard, Iraku 15.2 miliard, Kuvajti 13.3 miliard, Arabia Saudite 36 miliard, Emiratet 13 miliard dhe sasi më të vogla Omani, Katari, Jemeni dhe Siria. Formula "Forca është e drejta" zakonisht quhet e papranueshme, madje e neveritshme. Por

² President i zgjedhur i OLP-së në vitin 1968.

³ Xhejms G. Kellas “Politika e nacionalizmit.” fq. 206

askush nuk mund të mohojë se kjo formulë shpesh zbatohet në marrëdhëniet ndërkombëtare, sikurse edhe në marrëdhëniet midis individësh në shoqërinë njerëzore. Roli i SHBA në Euroazi nga Ballkani në Lindjen e Mesme është më i domosdoshëm se në çdo pjesë të botës dhe sigurisht do të jetë i pranishëm dhe mbisundues.

Por, nga ana tjetër SHBA bashkë me aleatët e saj të përhershëm BE dhe OKB kanë treguar një interes për të zgjidhur këtë konflikt nëpërmjet procesit paqësor me intenzitet më të theksuar që në vitin 1970. Raporti mes Izraelit dhe Palestinës ka një histori të gjatë të ndjekur nga luftërat, pushtimet, negociatat, rezolutat e Këshillit të Sigurimit të OKB-së, ndërmjetësime paqësore, marrëveshje të përkohshme paqësore, shkelje të të njëjtave dhe përsëri konflikte të reja që çojnë drejtë negociatave të reja. Disa nga proceset paqësore në të cilat edhe SHBA-të kanë një rol të rëndësishëm janë si vijon:

4.1. Procesi i negociatave Paqësore në Oslo në vitin 1993-Marrëveshja është firmosur në Washington në 13 shtator të v.1993 me një përhëndetje historike mes Arafatit dhe Rabinit që u prit me një duartrokitje dhe një marrëveshje mes palëve. Qëllimi i kësaj marrëveshjeje ishte që Izraeli gradualisht të lëshojë kontrollin nga territori palestinez. Pas atentatit ndaj Rabinit, marrëdhënjet mes Arafatit dhe Ehud Barak nuk shkonin në drejtimin e duhur dhe procesi rezultoi i pasuksesshëm. Robert Majli- Këshilltari special i Bill Klintonit (President i atëhershëm i SHBA-së) konfirmoi në atë kohë se Barak nuk ka pasur ofertë oficiale të shkruar nga ana e Arafatit dhe për këtë ka pikëvështrime të ndryshme rreth ofertave për marrëveshje. Një ndër pikat kryesore që ka penguar arritjen e marrëveshjes ka qënë statusi i Jerusalemit.

4.2. Samiti i Kamp Dejvid në vitin 2000- Presidenti amerikan Bill Klinton organizoi një Samit paqësor mes Presidentit Palestinez Jaser Arafat dhe Kryeministrit Izraelit Ehud Barak. Arafat refuzoi propozimin e Kryeministrit Barak dhe Presidenti Klinton akuzoi Arafatin për dështimin e këtij Samiti.

4.3. Samiti në Taba në vitin 2001-në këtë Samit ekipi negociues izraelit paraqiti kartën e re. Propozimi u pranua nga palestinezët por zgjedhjet e reja parlamentare në Izrael ku kryeministër u zgjodh Likud-Airel Sharon ndërpryen negociatat sepse kryeministri i ri ishte për mosvazhdimin e tyre.

4.4. Roadmap for Peace (2002)-Kuarteti i përbërë prej SHBA-së, BE-së, Rosisë dhe OKB-së propozoi një zgjidhje të re për konfliktin shumëvjeçar. Plani origjinal u përpilua nga Shërbimi Amerikan për Punë të Jashtme, e prezantuar nga ana e presidentit amerikan Gjorgj Bush në një fjalim të mbajtur në 24 Qërshor të vitit 2002, ku u paralajmërua “*shteti i pavarur palestinez që do të ekzistojë në një bashkejetese dhe paqe me izraelitet.*”⁴Teksti final i propozimit u publikua në vitin 2003 por paraprakisht asnjëra nga palët nuk pranuan propozimin.

4.5. Iniciativa Paqësore Arabe në Bejrut, 2002- kjo iniciativë u propozua nga Princi Abdullah i Arabisë Saudite. Iniciativa e Bejrutit u formalizua për herë të dytë në Samitin e Riadit në vitin 2007 dhe përgjigje e kësaj iniciative është Iniciativa Izraelite paqësore e vitit 2011 sipas të cilës Izraeli deklaroi se qëllimi bazë është arritja e një kompromisi historik që do sjellë deri në normalizimin e raporteve mes Izraelit dhe të gjitha shteteve arabe dhe islamike.

4.6. Negociatat direkte (shtator 2010)- Këto negociatat zhvillohen në mes Presidentit amerikan Barack Obama, Kryeministrit Benxhamin Netanjahu dhe presidentit të qeverisë palestineze Mahmud Abas. Në vitin 2011, Mahmud Abas paraqiti aplikim formal për pranim të shtetit të Palestinës në OKB dhe për antarësim në të, megjithatë Këshilli i Sigurimit vendosi që nuk mund të japë propozim me konsensus për pranimin e Palesintës në OKB. Në v.2012, Këshilli i Sigurimit të OKB-së me një rezolutë të veçantë i dha Palestinës statusin e shtetit mbikeqyrës pa të drejtë antarsimi të plotë që ngjason me statusin e Vatikanit në OKB. Në dhjetor të v.2012, shefi i protokollit të OKB-së deklaroi se në të gjitha dokumentet zyrtare të OKB-së, Qeveria Palestineze do të emërtohet si Palestina. Që nga viti 2012, OKB-ja e njeh Rripin e Gazës si pjesë të Palestinës.⁵

4.7. Rezoluta 2334 e Këshillit të Sigurimit 23 dhjetor 2016- Për herë të parë që prej vitit 1979, SHBA-ja nuk ka vendosur veton për një rezolutë të Këshillit të Sigurimit përse i përket kolonizimit izraelit, ndërkohë që ka mbështetur deri tani Izraelin për këtë çështje shumë të ndjeshme.

Abstenimi i saj, gjykuar si një votë pro nga 14 anëtarët e tjerë, mundësoi miratimin e këtij teksti. Izraeli ka reaguar ashpër ndaj rezolutës se Këshillit të Sigurimit të OKB-se që i kërkon shtetit hebreu të ndale ndërtimin e banesave të reja në territoret e pushtuara palestineze. Kryeministri Netanjahu e cilësoi dokumentin një akt të turpshëm.

⁴ US department of State, RoadMap for Peace, 2002

⁵ Izrael-Palestinë, gjithçka që duhet të dini mbi konfliktin, 2014, www.tiranaobserver.al

“Ne nuk do t’i bindemi kësaj rezolute. Në një kohë kur Këshilli i Sigurimit ka dështuar në ndalimin e masakrës ndaj gjysmë milioni njerëzve në Siri, paturpësisht i kundërvihet të vetmes demokraci në Lindjen e Mesme dhe e quan Bregun Perëndimor territore të pushtuara.” Këshilli prej 15 anëtarësh kaloi rezolutën e propozuar nga Egjipti pasi edhe Shtetet e Bashkuara pranuan miratimin e saj. Ekspertet thonë se një veprim i tillë shënon edhe kulmin e tensioneve mes amerikaneve dhe izraeliteve.

Shqipëria është pjesë e 119 vendeve, që votuan në favor të një rezolute, që lejon ngritjen e flamurit palestinez në selinë e OKB-se në Nju Jork. Tete vende anëtare të organizatës votuan kundër, ndërsa 45 të tjera abstenuan. Ky vendim ka zemëruar Izraelin, ndërsa palestinezet e shohin këtë votim si një hap drejt anëtarësimit në Kombet e Bashkuara. Mes atyre që abstenuan ishin pjesa më e madhe e 28 vendeve të Bashkimit Europian. Pro rezolutës ishte Franca, Italia e Spanja, ndërsa abstenuan Britania, Danimarka dhe Gjermania. Diplomatat palestineze janë shprehur se presin që flamuri të valëvitet në selinë e OKB-se në 30 shtator, kur udhëheqësi palestinez Abass do të mbaje një fjalim në Asamblenë e Përgjithshme.

KONKLuzion

Pavarësisht nga të gjitha problemet e tjera të Lindjes së Mesme – dhe në dukje të mëdha – konflikti izraelito-palestinez është çështja kyçe që do të përcaktojë nëse e ardhmja e rajonit do të jetë apo jo paqja dhe prosperiteti. Konflikti – pavarësisht nëse zgjidhet apo jo – do të ndihmojë në përcaktimin e trashëgimisë së politikës së jashtme të presidentit amerikan Barak Obama.

Ndërsa mandati i dytë i Obamës po i afrohet fundit, ia vlen të kujtohet se kur erdhi në pushtet në vitin 2009, kërkoi afrimin me botën muslimane. Në fjalimin e tij historik në Kajro në qershor të atij viti, Obama e përshkroi gjendjen e palestinezëve si “të patolerueshme” dhe premtoi të ndiqte – *“me gjithë durimin dhe përkushtimin që ia kërkon detyra”* – një politikë të *“dy shteteve, ku izraelitët dhe palestinezët të jetojnë secili në paqe dhe siguri”*.

Që prej asaj kohe, Obama ka bërë shumë pak përparim mbi këtë çështje, ndonëse jo për shkak të mungesës së përpjekjeve. Gjatë mandatit të parë të Obamës, kryeministri izraelit Benjamin Netanjahu dhe republikanët në Kongresin Amerikan, u bashkuar kundër tij për të penguar çdo përpjekje kuptimplotë për arritjen e paqes. Dhe gjatë mandatit të tij të dytë, sekretari

i tij i shtetit, Xhon Kerri, udhëhoqi një përpjekje heroike 9-mujore – që përfshiu pothuajse 100 takime dypalëshe me udhëheqësit izraelitë dhe palestinezë – dhe që mjerisht thjesht dështoi.

Por në qoftë se bota do që të shmangë një konfrontim të ardhshëm kataklizmik, ndërmjet një Izraeli të Madh në krijimin e sipër dhe një Palestine të mbështetur nga një aleancë më e madhe e vendeve arabe, kushtet për bisedime që çojnë në një zgjidhje të qëndrueshme mes dy shteteve duhet të krijohen që tani.

Referenca:

1. Llambro Filo, "Historia Boterore, shek XX", Albin, 1995;
2. H. Kisinger, "Diplomacia", Tiranë, 1999;
3. Israel Information Center, Facts about Israel, 1995;
4. D.Ola Abu Zejd, "Zhvillimi i filozofise politike ne Islam", shtëpia botuese "Al-Shark, Kajro 2001;
5. D.Muhamed Selim Al-Aua, "Sistemi politik i shtetit islam", botim i shtëpise botuese "Egjipti i ri" Kajro, 1983;
6. Sejjid Kutub, "Kjo Fe", Shkup 1995;
7. Hasan Al Bena, "Aspekti politik i Levizjes se Vellezerve muslimane", 2000;
8. Fred J. Khouri, "The Arab –Israeli dilemma", second edition, Syracuse University Press, 1976;
9. Lawrence Ziring, "The middle East Political dictionary", Clio Press LTD, 1984;
10. Ж.Ковачевиќ, "Меѓународно преговарање", Белград, 2004;
11. Albin, "Fairnes in International Negotiation", Cambridge, 2001;
12. Charles D. Smith, "Palestina and the Arab-Israeli conflict", second edition, ST Martin press 1992;
13. Razzuq As'ad, "Great Israel", Palestine research Center, 1970;

14. David Mcdowall, "Palestine and Israel", IB tauris and co.l.t.d London, 1990;
15. Ben Halpen, "The idea of a the Jewish state ", second edition, Harvard University, press 1969;
16. Botim i kishës Ortodokse Kopte "Kisha dhe çështja kombëtare", vëllimi i katërt, 1994;
17. Bashkurti, Lisen, "Krizat Ndërkombëtare" "GEER", Tiranë, 2008;
18. D.Kurtzer, S.Lasensky, "Negotiaating Arab-Israeli Peace American Leadership in the Middle East", Washington, 2008;
19. Israel Ministry of Foreign Affairs, "The Israeli-Palestinian Interim Agreement", Aneks 1, 1995;
20. Jerusalem Media and Communications Centre: Pool on Palestinian Public Opinion, 2008;
21. United Nations Office for the Coordination of Humanitarian Affairsm"Israeli-Palestinian Fatalities Since 2000-Key trends", 2007;
22. World Association of International Studies, "Israel and the Palestine right of return", 2008;
23. Y.Ginosaur, "The Camp David Samit-What Went Wrong?", 2012;
24. US departament of State, RoadMap for Peace, 2002;
25. United Nation Security Concul Resolution 2334, 23 December 2016, Adopted by the Security Council at its 7853-rd meeting.

PhD. Ruzhdi MATOSHI

Universiteti “UBT” Prishtinë

Prishtinë, Republika e Kosovës

matoshi.r@gmail.com

AGRITOURISM POTENTIAL AS A PERSPECTIVE IN KOSOVO

ABSTRACT

Tourism development is a broadly diversified activity from the rest of economic sectors. While in the economy a competition between the sectors is a key to better selection and specialization, tourism in general has some exceptions arising from the state support due to the importance this sector has in promoting the country abroad, through promotion, subsidies and programs, including intrastate programs and from the European Union. The main reason behind such a support lies on the needs of people for holidays, relax, health and food. The Republic of Kosovo has an area of 10.887 km² and a population of 1.8 million, where tourism development is seen as a need for the people at home as well as foreigners who visit Kosovo.

The strategy of tourism development should come as a result of interaction between many factors, among others, agribusiness and standardization of goods and services in Kosovo which, if developed at a satisfactory level, can generate new jobs and economic growth. Although tourism potential in Kosovo as a small country does not offer many choices, it has got some exclusive preconditions that are available in the mountains of Sharr, Curst Mountains, historical sites such as the city of Prizren, the Vushtrri Castle and many archaeological sites of different historical periods, are some of many examples for pushing the support in this respect. To find out where does Kosovo stand in this process and perspective, the aim of this paper is to critically assess the interaction between tourism and agriculture products as potential for agritourism, and address some recommendations as which would be a better alternative of its development.

JEL: F53, O24, Q18.

Keywords: *Republic of Kosovo, agritourism, subsidies, BE, heritage.*

INTRODUCTION

Agritourism is that branch of tourism revolving around agricultural activities. It may range from visiting the farms, picking up fruits and vegetables, food production, getting familiar by the visitors on certain farming techniques, walking, leisure, entertainment, and holidays in hotels or restaurants. As such, agritourism is becoming an industry on the rise in many parts of the world. One of the earlier and still ongoing forms of agritourism is organizing the events as host festivals to attract the visitors and potential buyers into rural areas to get familiar with local communities. The visits benefit local farmers or businesses and the visitors, especially if agritourism tends to be unique or different on its own. Different foods, plants, vegetables, natural environment, local customs and traditions, cuisine, and historical differences between the communities provide an opportunity for the development of this branch of tourism.¹ Interesting, this sector is attracting more attention and commitment in advanced industrialized nations.

The main resources of agritourism development are: i) assess potential success and challenges; ii) best management practices; iii) risk management and liability; iv) zoning and health considerations; vi) marketing; vii) associations and networks; and viii) online resources.² Apart from the strategies at national level, the sector is rapidly growing in interest in various regions within one country who prepare their own strategies at local level, something which even the national strategies often go on in exploring by districts. This happens due to the specificities each region has or is better known for. For example, as agritourism attracted the attention across North America, a study by a Canadian tourism agency identified it in the Ontario region as one of the seven priority projects.³ Similar regional strategies were prepared in the USA, to make the regions

¹ Kuehn, D., Hilchey, D., Ververs, D., Lynn Dunn, K., and Lehman, P. (1998), "Considerations for Agritourism Development", New York: Sea Grant Institute.

² Chase, L., Ramaswamy, V. M., Burr, S.V., Zeitin, J., Green, G.P. and Dougherty, M. (2007), "Resources of Agritourism Development", Iowa State University: Agricultural Marketing Resource Center.

³ Southwestern Ontario Tourism Corporation -SWOTC (2011), "Agritourism Development and Strategy and Marketing Plan", Ontario: Agritourism Focus Group Proceedings, SWOTC.

or states economically more viable, encourage agriculture to diversify their enterprises, make their products more value added and competitive, especially in the states of natural diversity such as Utah.⁴

Promoting and supporting agritourism development is made for the purpose of fostering rural development, but not in the manner to which urban construction has grown to large cities and conurbations, but mainly to preserve the environment, and from it to do business. This potential is witnessed in many developing countries, thus they have become aware of its development. The government of Kosovo is also focused on the perspective of agritourism and has prepared respective strategies to foster it.

METHODOLOGY AND SOURCES

The primary source of material for this paper are the Government strategies for development, especially those related to tourism development, which are taken for analysis. A number of statistics are gathered as secondary data from official publications in Kosovo to find out the trend and the state of tourism in general, then various data are selected for agritourism. All three are analyzed to get a an overview on the potentials for agritourism development.

AGROTOURISM VERSUS OTHER TYPES OF TOURISM IN KOSOVO

In the aftermath of 1999 war Kosovo was at the center of many international organizations and visitors. Initially, a United Nations Interim Administration (UNMIK) was established with a mission to restore peace and provide assistance for reconstruction and development. Along with it, a number of individuals apart from their curiosity to get more familiar of the war torn society, begun to explore Kosovo into more details, in particular her cultural heritage and landscape.

What Kosovo is known for regarding tourism in general? First, ethnic composition where majority of her people under 2 million is Albanian, and including minorities such as Serbs, Bosniaks, Turks, Egyptians and Romani, each of them having distinct ethnic and religious

⁴ Institute for Outdoor Recreation and Tourism (2011), "Utah Recreation and Tourism Matters", Price: Utah State University, No. IORT/026.

characteristics. Second, religious heritage. The overwhelming majority of Albanians are Muslims with fewer than 2% of them being Roman Catholics. Bosnians, Turks, Egyptians and Romani are also Muslim. The Serbs who are the largest minority, are Eastern Orthodox. Third, derived from the second, cultural heritage involving architecture, cuisine, unique traditions, and landscape. Although a small area, Kosovo is relatively rich in cultural heritage dating back as far as 3 500 BC. One of such proofs is the discovery of the Goddess on the Throne in the outskirts of Pristina capital city in 1956. The heritage of ancient Illyrian civilization has been discovered all over Kosovo, namely of the Dardani tribe.⁵ Of particular importance were some archaeological excavations in the 21st century, especially the artifacts containing engravings from sacred geometry from the Bronze Age, such as the Flower of Life, Tree of Life, Illyricum Sacrum (Star of David), crescent moon with five-pointed star. These and associated discoveries have been explored from academic and policy point of view for archaeotourism development, though a study by Mulaj found that Kosovo does not have, among others, an organized research apparatus and expertise to make it work, and recommended that foreign scholars and foundations should further research the matter in Kosovo.⁶ the Medieval heritage is rich and diversified, beginning with Byzantine, Slavic, Ottoman and Albanian culture. A part of that heritage has been destroyed or vandalized in the course of historical events. during the reign of communism, a number of religious objects such as churches, mosques and synagogues have been destroyed. During the 1999 conflict, the Serbs burned hundreds of mosques. In the March 2004 riots, Albanian mobs set ablaze dozens of Serb orthodox churches. The diversity when it evolved in ethnic and/or religious hate, drew the international attention that Kosovo's cultural heritage must be protected.

The number of visitors to Kosovo has been constantly growing over the last three years. There 11,458 foreign tourists visiting Kosovo in the last quarter 2013, a number which has almost

⁵ Berisha, Milot (2012), "Archaeological Guide to Kosovo", Pristina: Ministry of Culture, Youth and Sport of the Government of the Republic of Kosovo.

⁶ Mulaj, Isa (2015), "What Marketing Strategy for Sacred Geometry Discoveries to Make Archaeotourism Work?", *Global Journal of Human-Social Science*, Vol. 15, No. 10, pp. 30-38.

doubled to 22,887 in the third quarter 2015. Along with it, the number of days/night spent in Kosovo also grew substantially from 18,854 to 33,317 over the same periods.⁷




Figure 1: The trend of local (Series 1) and foreign visitors (Series 2) and their days/night of stay (Series 3 for local and Series 4 for foreign) in Kosovo from Q1 2008 to Q3 2015.

Source: Kosovo Agency of Statistics (2015), “Statistics of Hostelry: Q3-2015”, Series 3: Economic Statistics, Pristina: Kosovo Agency of Statistics, p.9.

